

Vlerësim i mekanizmave të nivelit lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë

Qershor, 2014

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PËRMBAJTJE

LISTË E SHKURTESAVE.....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. HYRJE	5
2. SHQYRTIM I KORNIZËS LIGJORE DHE POLITIKAVE QË RREGULLOJNË MEKANIZMAT E KOMUNITETIT NË NIVEL KOMUNAL	7
2.1 Korniza ligjore në Kosovë.....	8
2.2 Baza ligjore dhe e politikave për funksionim efektiv të katër mekanizmave	9
2.2.1 Nënkryetari i komunës për komunitete	9
2.2.2 Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete (ZKKKK)	10
2.2.3 Komiteti për Komunitete (KK)	11
2.2.4 Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK).....	12
2.3 Balanca gjinore	14
2.4 Përmbledhje e gjetjeve	14
3. SHQYRTIM I THEMELIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KATËR MEKANIZMAVE.....	16
3.1 Nënkryetari për komunitete	16
3.2 Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete	18
3.3 Komitetet për Komunitete	19
3.4 Zyrat komunale për komunitete dhe kthim	22
3.5 Balanca gjinore	26
3.6 Përmbledhje e gjetjeve.....	27
4. PËRFUNDIME	30
5. REKOMANDIME	32
SHTOJCA 1 – TABELA: THEMELIMI I MEKANIZMAVE LOKALË PËR MBROJTJE (NDARJA SIPAS KOMUNAVE)	36
SHTOJCA 2 – TABELA: PÛRKATËSIA ETNIKE DHE GJINIA E NKK-ve DHE ZKKKK-ve (NDARJA SIPAS KOMUNAVE)	37
SHTOJCA 3 – DIAGRAMI: PËRFAQËSIMI I MANGËT (JO I KËNAQSHËM) I KOMUNITETEVE NË KK (NDARJA SIPAS KOMUNITETIT).....	38
SHTOJCA 4 – TABELA: NUMRI DHE GJINIA E ANËTARËVE TË KK DHE PUNONJËSVE TË ZKKK (SIPAS KOMUNAVE)	38
SHTOJCA 5 – DIAGRAME: PËRGJIGJET NË ANKETË NGA MEKANIZMAT PËR KOMUNIKIM, BASHKËPUNIM DHE PËRDORIM TË GJUHËVE	40

LISTË E SHKURTESAVE

Komiteti për komunitete	KK
Nënkryetari i komunës për komunitete	NKK
Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete	ZKKKK
Ministria për Komunitete dhe Kthim	MKK
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	MAPL
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	ZKKK
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë	OSBE
Termet e referencës	TR

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Katër mekanizmat kryesorë të pjesëmarrjes në qeverisje lokale me përgjegjësi të veçanta për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë janë: komitetet për komunitete (KK), zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) dhe postet e nënkryetarit të komunës për komunitete (NKK) dhe zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete (ZKKKK). Këto janë mekanizmat kryesorë që i ndihmojnë institucionet e Kosovës për t'i përmbushur kriteret e rëndësishme të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP)¹ dhe të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK)² duke siguruar plotësimin e së drejtës së komuniteteve për të marrë pjesë në qeverisje dhe çështje publike, element jetik ky në aftësinë e komuniteteve për t'i realizuar shumë të drejta të tjera (p.sh., të drejtën për arsim, lirinë nga diskriminimi, qasjen e barabartë në shërbime, etj.). Ndonëse kanë potencialë për të funksionuar si një sistem koherent në nivel lokal, aftësia e këtyre katër mekanizmave për të vepruar ashtu ndikohet negativisht nga mangësitë e konsiderueshme në kornizën ligjore dhe problemet e shumta në zbatim praktik.

Mungesa e akteve nënligjore të mjaftueshme dhe të hollësishme që e lehtësojnë zbatimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale³ i lë vendimmarrësit dhe aktorët pa udhëzime të sakta mbi funksionimin praktik të tre nga katër mekanizmat, me udhëzime minimale për postet e NKK-ve dhe ZKKKK-ve dhe të gjitha hollësitë materiale për funksionimin e KK-ve që ekzistojnë vetëm në politikat udhërrëfyese pa fuqinë e akteve nënligjore. Ana pozitive është se disa poste të NKK-ve u themeluan edhe pse nuk ishin të detyrueshme dhe duket se raportet mes komuniteteve kanë përfituar nga puna dhe ekzistenca e të gjithë katër mekanizmave. Ndonëse respektimi i kornizës ligjore ekzistuese ka shënuar përmirësim, ka probleme që kanë vazhduar: një pozitë e detyrueshme e NKK-së nuk është krijuar dhe një pozitë e ZKKKK-së ka mbetur e paplotësuar për më shumë se një vit; asnjë KK e vetme nuk përfaqëson të gjitha komunitetet në komunat gjegjëse dhe disa nga ZKKK-të nuk kishin punonjës të mjaftueshëm. OSBE-ja gjeti se dy të tretat deri në tre të katërtat e të gjitha KK-ve dhe një çerek e deri gjysma e ZKKK-ve kanë dështuar që t'i zbatojnë detyrat thelbësore të përcaktuara me mandat. Shqetësimet shtesë përfshijnë mungesën e një raportimi të qartë dhe mbikëqyrjen, bashkëpunimin e dobët mes mekanizmave, shpërfilljen si prioritet të punës së mekanizmave nga aktorët e tjerë komunalë, përfaqësimin shumë të dobët të grave dhe perceptimin se mekanizma shpeshherë anashkalojnë interesat e komuniteteve më të vogla.

Me qëllim të trajtimit të mangësive të lartcekura, institucionet e nivelit qendror në Kosovë, posaçërisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, duhet të miratojnë akte nënligjore të hollësishme përkitazi me funksionimin praktik të mekanizmave si dhe të ndërmarrin veprime të monitorimit dhe ndërtimit të kapaciteteve dhe të rrisin mbështetjen dhe udhëzimet për komunat. Institucionet e nivelit lokal duhet të sigurojnë respektimin e plotë të kërkesave ligjore dhe

¹ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966), <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx> (qasur më 3 maj 2014).

² Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Raporti Shpjegues (1995), [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/1_atglance/PDF_H\(95\)10_FCNM_ExplanReport_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/1_atglance/PDF_H(95)10_FCNM_ExplanReport_en.pdf) (qasur më 3 maj 2014).

³ Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 20 shkurt 2008. Teksti i plotë është në dispozicion në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf (qasur më 3 maj 2014).

në rastet kur nuk është e detyrueshme, por e dobishme, të shqyrtojnë themelimin e posteve të NKK për të përkrahur raportet mes komuniteteve. Komunitetet gjithashtu duhet të sigurojnë se të gjithë mekanizmat kanë qasje në burimet e nevojshme për të kryer punën e tyre (p.sh., përkthim, qasje në kompjuter, etj.) duke përfshirë vizitat dhe komunikimin me komunitetet dhe se ka raportim të rregullt dhe transparent për punën e tyre. Përveç kësaj, udhëheqja komunale do të duhej të ndërmerre hapa për të emëruar më shumë femra dhe për të siguruar procese transparente dhe të paanshme të emërimit, si dhe për të mbështetur bashkërendimin mes katër mekanizmave dhe fuqizimin e tyre si elemente jetike për qeverisjen lokale në Kosovë.

1. HYRJE

Mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal u ofrojnë ndihmë të konsiderueshme komuniteteve në pakicë numerike në cilëndo komunë për t'i realizuar të drejtat e tyre të njeriut në arsim, lirinë nga diskriminimi, lirinë e besimit, në punësim dhe në qasjen në shërbime dhe mirëqenie sociale, mes të tjerash.

Në Kosovë organet kyçe që veprojnë në nivel lokal për të mbështetur të gjitha komunitetet në gëzimin e barabartë të drejtave të tyre për të marrë pjesë në çështje publike⁴ janë: komitetet për komunitete (KK), zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) dhe postet e nënkryetarit të komunës për komunitete (NKK) dhe zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete (ZKKKK).⁵ Themelimi i tyre në vitin 2008 pasqyroi zhvillimin e sistemit të qeverisjes lokale në Kosovë për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve, dhe funksionimi i këtyre mekanizmave në praktikë është i rëndësishëm për të siguruar këto të drejta.

Në vitin 2009, një raport i OSBE-së⁶ gjeti se “korniza ligjore [në Kosovë] nuk është duke u zbatuar në mënyrë adekuate [dhe] se mekanizmat ekzistues nuk u sigurojnë gjithmonë komuniteteve mbrojtje të duhur dhe efektive e as nuk e garantojnë pjesëmarrjen e tyre.”⁷ Ndonëse gjendja është përmirësuar dukshëm që nga raporti i vitit 2009, disa komuna vazhdojnë që të mos respektojnë detyrimet e tyre ligjore. Raporti i vitit 2012 i OSBE-së për

⁴ Siç ceket nga MAPL-ja: “...me funksionalizimin e ZKK-ve, duke përfshirë edhe strukturat e nivelit përfaqësues (përkatesisht mekanizmave të Kuvendit e Komunës) siç janë: komiteti për komunitete, zv. kryesuesi për komunitete dhe nënkryetari i komunës për komunitete, përmbyllin kornizën e mekanizmave të brendshëm komunal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.” . 18, *Raport i funksionimit të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës*, janar-qershor 2013, MAPL qershor 2013. <https://mapl.rks-gov.net/Raporte/2013.aspx> (qasur më 3 maj 2014).

⁵ Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKS) janë një mekanizëm tjetër i rëndësishëm për pjesëmarrjen e komunitetit në qeverisjen lokale, megjithëse ato kanë një mandat të veçantë përkitazi me sigurinë dhe nuk veprojnë si mekanizma bazë për funksionimin e administratës së qeverisjes lokale dhe prandaj ato nuk janë përfshirë në këtë hulumtim. Një aspekt tjetër i pjesëmarrjes që nuk është i përfshirë në këtë raport është pjesëmarrja e pjesëtarëve të komunitetet në shërbimin civil e që është trajtuar drejtpërdrejtë në raportin e vitit 2013 të OSBE-së për *Përfaqësimin e Komuniteteve në Shërbimin Civil në Kosovë* (shkurt 2013). <http://www.osce.org/kosovo/99601> (qasur më 3 maj 2014).

⁶ Raport i OSBE-së *Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë: mekanizmat e pjesëmarrjes në nivel lokal* (dhjetor 2009) <http://www.osce.org/kosovo/40722> (qasur më 3 maj 2014)) (Raporti për pjesëmarrjen i vitit 2009).

⁷ Po aty, f. 25.

*Vlerësimin e të Drejtave të Komuniteteve*⁸ konstatoi që “mbesin mangësi në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë”, dhe në veçanti derisa ekzistojnë mekanizma të nivelit lokal të themeluar në Kosovë për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e komuniteteve, këto mekanizma nuk dëshmohen gjithmonë efektive. Në raport gjithashtu ceket mungesa e mbështetjes komunale për mbrojtjen e komunitetit lokal.⁹ Veprimtaritë e monitorimit të OSBE-së gjatë vitit 2013 vërtetuan se shumë prej këtyre mekanizmave të nivelit lokalë vazhdojnë që të funksionojnë në mënyrë të paqëndrueshme dhe të papërshtatshme në zbatimin e detyrimeve të tyre.

Institucione të reja të qeverisjes lokale në Kosovë tani janë në proces të formimit si rezultat i zgjedhjeve të mbajtura në nëntor dhe dhjetor të vitit 2013. Duke pasur parasysh rolin vendimtar që KK, ZKKK, NKK dhe ZKKKK kanë si mekanizma të themeluar posaçërisht për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në nivel lokal, ky raport mëton që të sigurojë një vlerësim për funksionimin e katër mekanizmave dhe të identifikojë hapat kryesorë për përmirësim me qëllim të dhënies së kontributit dhe përmirësimit për themelimin, fillimin e punës dhe funksionimin e këtyre katër mekanizmave në të ardhmen. Në pjesën 2 më poshtë shqyrtohen zbraçetirat dhe mangësitë në kornizën ligjore për themelimin e katër mekanizmave (duke përfshirë aktet nënligjore) si dhe mandatet e mekanizmave përkatës. Në pjesën 3 vlerësohet nëse këta mekanizma janë themeluar ashtu siç duhet. Në këtë pjesë gjithashtu vlerësohet puna e tyre, posaçërisht respektimi nga ana e tyre i detyrimeve sipas kornizës ligjore dhe të politikave gjatë periudhës prill 2012 deri në tetor 2013. Në pjesën 4 paraqiten konstatimet dhe rekomandimet për vendimmarrësit dhe aktorët për atë se si duhet përmirësuar kornizën ligjore dhe punën e katër mekanizmave, me qëllim të avancimit të pjesëmarrjes së komuniteteve të Kosovës në qeverisjen lokale dhe mbrojtjes dhe promovimit të drejtave dhe interesave të tyre.

Sqarim për metodologjinë

OSBE-ja identifikoi parametrat e hulumtimit dhe fushat kryesore të fokusit të këtij raporti në bazë të raportimit të rregullt nga terreni gjatë vitit 2012 dhe 2013, plotësuar nga rishikimi i kornizës ligjore dhe të politikave. Pas identifikimit të pikave kryesore që duhet të respektohen, hulumtuesit e OSBE-së monitoruan dhe vlerësuan katër mekanizmat lokalë në 34 komuna¹⁰ gjatë një periudhe prej 18 muajsh, pra nga muaji prill i vitit 2012 deri në muajin tetor të vitit 2013. Përveç kryerjes së vlerësimeve të veta për funksionimin dhe respektimin e detyrimeve gjatë asaj periudhe, hulumtuesit e OSBE-së mblodhën të dhëna përmes intervistave anketuese që u zhvilluan me 250 aktorë gjegjësisht nga muaji prill deri në muajin qershor të vitit 2013, duke përfshirë anëtarët e katër mekanizmave në fjalë, anëtarët e kuvendeve të komunave dhe përfaqësuesit e komunitetit të cilët nuk janë të përfshirë në çështjet a politikën komunale.¹¹ Në Shtojcën 5 paraqiten përgjigjet për

⁸ Raport i OSBE-së, *Raport për vlerësimin e të drejtave të komunitetit – botimi i tretë* (korrik 2012 2012). <http://www.osce.org/kosovo/92244> (qasur më 3 maj 2014).

⁹ Po aty, f. 5 dhe f. 35.

¹⁰ Komunat Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan/Zveçan si dhe Mitrovica veriore u përjashtuan nga anketa duke qenë se këto komuna nuk po e zbatonin kornizën ligjore gjegjësisht të Kosovës gjatë periudhës së vlerësimit.

¹¹ Nga gjithsej 250 intervista, 13 u zhvilluan me ZKK, 14 u zhvilluan me ZKKKK, 56 intervista u zhvilluan me anëtarët e KK, 55 intervista u zhvilluan me personelin e ZKKK-ve, 51 intervista u zhvilluan me anëtarët e

temat e rëndësishme që u mbledhën gjatë kësaj ankete. Prandaj raporti është i bazuar në një përzierje të dhënave sasiore dhe cilësore që janë nxjerrë nga një gamë e burimeve, brenda dhe jashtë këtyre katër mekanizmave.

2. SHQYRTIM I KORNIZËS LIGJORE DHE POLITIKAVE QË RREGULLOJNË MEKANIZMAT E KOMUNITETIT NË NIVEL KOMUNAL

Korniza ligjore në Kosovë siguron një seri detyrimesh për institucionet e Kosovës për të mbrojtur dhe promovuar pjesëmarrjen e barabartë të komuniteteve në qeverisjen lokale. Instrumentet kyçe ndërkombëtare që sigurojnë të drejtën e pjesëmarrjes së barabartë në çështjet publike janë Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) dhe Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMPK) dhe që të dyja zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë. PNDKP shprehimisht përcakton se çdo qytetar ka të drejtën të marrë pjesë në çështjet publike pa qenë i diskriminuar.¹² KKMPK gjithashtu u kërkon qeverive që të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen efektive të komunitetit në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike.¹³ Në mënyrë që të përmbushin këto detyrime, qeveritë do të duhej të ndërmerrnin hapat si në vijim:

- T'i konsultojnë komunitetet për legjislacionin apo masat administrative që mund të ndikojnë mbi ato në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes institucioneve të tyre të përfaqësimit dhe me procedura të tjera të përshtatshme;
- T'i përfshijnë komunitetet në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e planeve dhe programeve të nivelit qendror dhe atij lokal që mund të ndikojnë mbi ato në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- Të kryejnë studime me bashkëpunim me këto komunitete për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të veprimtarive të projektuara të zhvillimit mbi ato;

kuvendeve të komunave, duke përfshirë, kudo që ishte e mundshme, anëtarët e partive opozitare dhe 61 intervista u zhvilluan me përfaqësuesit e komuniteteve pa ndonjë përkatësi politike (p.sh., shoqërinë civile, punëtorët, mësimdhënësit, etj.). Në çdo komunë u zhvilluan mes tetë dhe dhjetë intervista dhe kudo që ishte e mundshme u intervistuan dy të anketuar për çdo kategori nga gjini dhe komunitete të ndryshme. Në përgjithësi, për shkak të asaj se meshkujt emërohen më shpesh në këto poste, më pak se një e treta, pra vetëm 74 të anketuar ishin femra. Shumica e të anketuarve, pra 106 (42 për qind) i përkasin komunitetit shqiptar të Kosovës, 49 (20 për qind) i përkasin komunitetit serb të Kosovës, rreth 20 (7 deri në 8 për qind) i përkasin komuniteteve romë, boshnjak, ashkali të Kosovës, dhe 12 apo më pak se aq (më pak se 5 për qind) i përkasin komuniteteve egjiptian, turk, goranë, malazezë dhe kroat të Kosovës. Ndonëse nuk është e rëndësishme në kuptimin statistikor për popullsinë e shumëllojshme që u anketua, ky numër i konsiderueshëm i intervistave ofroi një bazë të qëndrueshme për nxjerrjen e vështrimeve dhe konstatimeve të rëndësishme.

¹² Neni 25 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, *fusnota 1* e cituar më sipër: “Çdo qytetar ka të drejtën dhe mundësinë, pa asnjë dallim të përmendur në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; (b) Të votojë dhe të zgjidhet gjatë zgjedhjeve periodike, të ndershme, me votim të saktë dhe të barabartë e me votë të fshehtë, që sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, të kryejë funksione publike në vendin e tij.”

¹³ Neni 15 i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Raporti Shpjegues (1995), *fusnota 2* e cituar më sipër: “Palët do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta.”

- Të mundësojnë pjesëmarrjen efektive të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes dhe në organet e zgjedhura në nivel qendror dhe atë lokal si dhe në format e decentralizuara apo lokale të qeverisjes.¹⁴

2.1 Korniza ligjore në Kosovë

Korniza ligjore në Kosovë përcakton që institucionet e Kosovës duhet të marrin masa afirmative për të promovuar barazinë mes komuniteteve në fushat e jetës shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike dhe përfshin garanci të veçanta për pozitën e zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete.¹⁵

Legjislacioni parësor përkatës për katër mekanizmat është Ligji për vetëqeverisjen lokale¹⁶ (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji), preambula e së cilit cek nevojën për të promovuar një sistem të qeverisjes që është në gjendje të trajtojë “nevojat e posaçme dhe brengat e komuniteteve joshumicë”. Me anë të këtij Ligji themelohen (a) komitetet e përhershme për komunitetet në nivel komunal për të rishikuar respektimin nga organet komunale të ligjeve të zbatueshme, veprimeve dhe praktikave që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve¹⁷ dhe (b) në komunat ku së paku 10 për qind e banorëve i takojnë komuniteteve joshumicë, krijohet posti i zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete¹⁸ si dhe posti i nënkryetarit për komunitete.¹⁹ Për fat të keq, Ligji nuk është shoqëruar me akte nënligjore gjithëpërfshirëse për të dhënë udhëzime mbi çështjet praktike të zbatimit dhe një dështim i rëndësishëm është mungesa e hollësive për tre mekanizmat kyç për pjesëmarrjen e komunitetit që themelohen sipas tij.

I vetmi përjashtim i shquar në bazë të Ligjit (dhe në bazë të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre²⁰) është Rregullorja për zyrat komunale për komunitete dhe kthim (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregullorja)²¹ që ndërthuri funksionet e ish zyrave komunale për komunitete dhe ish zyrave komunale për kthim për të themeluar ZKKK. Rregullorja përmban një nivel më të plotë të hollësive për mekanizmin e ZKKK sesa që përmban Ligji për tre mekanizmat e tjerë. Veç kësaj, miratimi rishtazi i Udhëzimit administrativ për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna²² (në tekstin e mëtutjeshëm: Udhëzimi administrativ) siguron disa udhëzime shtesë për pozitën e NKK.

¹⁴ KKMPK dhe Raporti Shpjegues (1995), paragrafi 80 i raportit shpjegues, neni 15 i KKMPK, fusnota 2 e cituar më sipër.

¹⁵ Paragrafi 4 i nenit 58 dhe neni 62 i Kushtetutës së Kosovës për postin e ZKKK që ceket këtu si “zëvendëskryesues i kuvendit të komunës për komunitete”.

¹⁶ Ligji për vetëqeverisjen lokale, fusnota 3 e cekur më sipër.

¹⁷ Po aty, nenet 51 dhe 53 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale miratuar më 2008.

¹⁸ Po aty, nenet 54 dhe 55.

¹⁹ Po aty, neni 61.

²⁰ Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Teksti i plotë i ligjit është në dispozicion në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_en.pdf (qasur më 3 maj 2014).

²¹ Rregullorja nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim, 12 gusht 2010. Teksti i plotë i Rregullores është në dispozicion në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_per_Zyrat_komunale_per_Komunitete_dhe_Kthim.pdf (qasur më 3 maj 2014).

²² Udhëzimi administrativ nr. 2014/01 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna, 28 janar 2014. Teksti i plotë i udhëzimit administrativ është në dispozicion në <http://mapl.rks->

2.2 Baza ligjore dhe e politikave për funksionim efektiv të katër mekanizmave

Për vlerësimin e bazës legjislative për këta mekanizma, janë marrë në konsideratë katër kritere kryesore: (i) procesi i emërimit (dhe përbërja për Komitetet për Komunitete dhe ZKKK-së); (ii) qëllimi dhe synimi i mekanizmit; (iii) mandati dhe përgjegjësitë; dhe (iv) sistemet për raportim dhe mbikëqyrje.

2.2.1 Nënkyetari i komunës për komunitete

Ligji përmban vetëm një nen për mekanizmin e nënkyetarit për komunitete (NKK),²³ i cili plotësohet me udhëzimin administrativ.²⁴ Përkitazi me katër kriteret e vlerësuara, është përcaktuar si në vijim:

- i. **Emërimi.** Procesi i emërimit (dhe shkarkimit) të NKK-së është fushë që është rregulluar në detaje nga një nen në ligj që i adresohet kësaj pozite, por ka dispozita shtesë në Udhëzimin Administrativ.²⁵ Në komunat ku “të paktën 10 për qind e qytetarëve i përkasin komuniteteve joshumicë”²⁶, kryetari i komunës duhet t’i propozojë kandidatët për pozitën e NKK-së, të cilët duhet të miratohen nga shumica e anëtarëve të kuvendit komunal të pranishëm dhe që votojnë, ku vendet e zbrazëta duhet të plotësohen brenda 30 ditëve. Mandati i kësaj pozite shkon paralelisht me mandatin e kryetarit të komunës. Udhëzimi administrativ gjithashtu kërkon që kandidatët të jenë banor të komunës për së paku tri vite, dhe të jenë “anëtarë të grupit të pakicës që përbënë komunitetin më të madh pakicë në komunë”.²⁷
- ii. **Synimi dhe qëllimi.** Ekziston synim i qartë (ndonëse i gjerë) i këtij mekanizmi në ligj: NKK, “i ndihmon kryetarit dhe ofron këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë”²⁸. Dhe anasjelltas, Kryetari i komunës është gjithashtu i obliguar që ta “konsultojë” NKK-në për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet.
- iii. **Mandati dhe përgjegjësitë.** Nuk ekzistojnë dispozita në ligj që tregojnë për ndonjë mandat dhe përgjegjësi specifike, dhe Udhëzimi Administrativ jep detaje shtesë të cilat janë të kufizuara, pra thekson që NKK-ja “i mbështetë dhe konfirmon kërkesat e komuniteteve pakicë pranë organeve komunale”²⁹. As ligji e as Udhëzimi Administrativ nuk tregojnë se si pozita e NKK-së duhet të ndërlihet me ndonjërin nga tre mekanizmat e pjesëmarrjes së komunitetit (për disa pozita, disa statute të komunave individuale ofrojnë detaje shtesë në këtë aspekt).

gov.net/getattachment/4920ed63-3d4a-4fa5-9836-42b2f5d53af9/Udhezimi-administrativ-MAPL-Nr-2014-01-per-procedu.aspx (qasur më 3 maj 2014).

²³ Ligji për vetëqeverisjen lokale, neni 61 shënimi 3 më sipër.

²⁴ Shënimi 22 më sipër.

²⁵ Udhëzimi Administrativ nr. 2014/01, neni 4, shënimi 22 më sipër.

²⁶ Ligji për vetëqeverisjen lokale, neni 61, shënimi 3 më sipër.

²⁷ Po aty, Neni 6.

²⁸ Ligji për vetëqeverisjen lokale, Neni 58 (I), shënimi 3 sipër.

²⁹ Udhëzimi Administrativ nr. 2014/01, neni 5, shënimi 22 sipër.

- i. **Raportimi dhe mbikëqyrja.** Nuk ka dispozita që tregojnë për ndonjë sistem të raportimit për punën e NKK-së,³⁰ përtej supozimit që duke e pasur parasysh përgjegjësinë e kësaj pozite për këshillimin e kryetarit, NKK-ja do t'i raportonte dhe do të mbikëqyrej nga kryetari i komunës.

2.2.2 Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete (ZKKKK)

Legjislacioni aktual për mekanizmin e ZKKKK-së përbëhet nga një nen në Kushtetutë³¹ dhe dy nene në Ligj, të cilat e pasqyrojnë formulimin e dispozitave kushtetuese.³² Përkitazi me katër kriteret e vlerësuara, ato përcaktojnë si në vijim:

- i. **Emërimi.** Në komunat ku 10 apo më tepër për qind e banorëve i përkasin komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal, ligji parasheh që " Postin e zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës joshumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës", përfshirë këtu kriterin që bartësi i këtij posti duhet të jetë anëtarë i komunitetit që është pakicë numerike në komunë.³³ Ligji në asnjë vend nuk i referohet ndonjë procesi për shkarkimin dhe ka mungesë të udhëzimit përkitazi me emërimin e mundshëm të ZKKKK-ve jo të detyrueshëm në komunat që kanë më pak se 10 për qind të qytetarëve nga radhët e komuniteteve në pakicë numerike në komunë.
- ii. **Synimi dhe qëllimi.** Synimi për këtë mekanizëm është i qartë, ngase neni 55 i parasheh dy funksione kyçe për ZKKKK-në, i cili a) "e promovon dialogun ndërmjet komuniteteve", dhe b) "shërben si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në mbledhjet e Kuvendit dhe punën e tij."³⁴
- iii. **Mandati dhe përgjegjësitë.** Ligji e bënë një referim të kufizuar në mandatin specifik, ku thuhet se ZKKKK "është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e kuvendit të komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre", dhe është përgjegjës për referimin e ankesave të tilla në kuvendin komunal për rishqyrtim.³⁵ Në rast se kuvendi vendos që të mos e rishqyrtojë çështjen apo nëse edhe pas rishqyrtimit prapë vazhdon shkelja, ZKKKK ka mandat që në atë fazë t'i dorëzojë rastet drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese, e cila është një kanal i rëndësishëm për komunitetet për të kërkuar korrigjim të veprimit nga niveli qendror. Mirëpo, nuk ka asnjë dispozitë që tregon se si posti i ZKKKK-së duhet të ndërveprojë me ndonjërin nga tre mekanizmat tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve.

³⁰ Derisa nuk ka dispozita në Ligjin për vetëqeverisjen lokale që kanë të bëjnë me obligimin e raportimit për ZKK-në, Ligji për Shërbimin Civil e parasheh këtë si parim themelor për të gjithë shërbyesit civil; shih nenin 5, 1.5 për Llogaridhënie, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, 25 qershor 2010. Teksti i plotë i qasshëm në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-149-eng.pdf> (i qasur më 3 maj 2014).

³¹ Shënimi 15 sipër.

³² Ligji për vetëqeverisje lokale 2008, nenet 54 dhe 55, shënimi 3 sipër.

³³ Po aty, neni 54.

³⁴ Po aty, neni 55.

³⁵ Po aty, neni 55.

- iv. **Raportimi dhe mbikëqyrja.** Nuk ka dispozita që tregojnë për ndonjë sistem të raportimit apo mbikëqyrjes së punës së ZK-ve.

2.2.3 Komiteti për Komunitete (KK)

Siç është theksuar më lartë, Ligji shërben edhe për punën e KK-së, i cili është themeluar si njëra nga dy “komitetet e përhershme” në kuadër të kuvendit komunal.³⁶ Dy dokumente të politikave të nxjerra në vitin 2012 ofrojnë udhëzime të rëndësishme shtesë për punën e KK-së: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) i ka miratuar termet e referencës së KK-së³⁷, dhe udhëzimet e KK-së³⁸. Që të dy këto dokumente të politikave janë zhvilluar si reagim ndaj nevojës për më shumë udhëzim për komunitetet dhe komunat përkitazi me rolin e komitetit për komunitete dhe funksionimin e tij. Përkitazi me katër kriteret e vlerësuara, ato përcaktojnë si në vijim:

- i. **Emërimi dhe përbërja.** Derisa neni 53 parasheh disa kriteret për përbërjen e KK-së, duke thënë që duhet të përfshijë anëtarë të kuvendit komunal dhe së paku një përfaqësues të çdo komuniteti që banon në komunë (përfaqësuesit e komuniteteve duhet të përbëjnë shumicën e anëtarëve) ekzistojnë dallime ndërmjet versionit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze dhe serbe të Ligjit.³⁹ Ligji nuk parasheh ndonjë detaj lidhur me procesin e emërimit. Andaj, termet e referencës së KK-së shërbejnë si mjet i rëndësishëm për adresimin e kësaj mungese të udhëzimit, duke e përvijuar procesin përzgjedhjes së anëtarëve të komitetit, përfshirë kriteret që duhet plotësuar nga ata (neni 4 i termeve të referencës së KK-së) dhe proceset e përzgjedhjes së kryesuesve dhe zëvendëskryesuesve (neni 6), si dhe procesin e shkarkimit (neni 14). Udhëzimet e KK-së shkojnë edhe më tutje, duke propozuar praktika të mira për kontaktimin e komunitetit për të inkurajuar pjesëmarrje kuptimplotë (neni 2). Mirëpo, nuk ka kurrfarë udhëzimi për emërimin e anëtarëve të kuvendit komunal nga radhët e komunitetit që është pakicë numerike në një komunë të caktuar në Komitetin për Komunitete.
- ii. **Qëllimi dhe synimi.** Ligji e përshkruan synimin e KK-së si në vijim: për të “siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht” përmes rishikimit dhe dhënies së rekomandimeve për politika dhe veprime komunale.⁴⁰
- iii. **Mandati dhe përgjegjësitë.** Ligji jep ca detaje për mandatin dhe përgjegjësitë, duke theksuar që KK-duhet: ta shqyrtojë përputhshmërinë e autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve” që ndërlidhen me të drejtat e komuniteteve, dhe t’i rekomandojë kuvendit komunal masa që i konsideron të përshtatshme për të siguruar zbatimin e

³⁶ Po aty., Nenet 51 dhe 53.

³⁷ MAPL, termet e referencës së Komitetit për Komunitete, Vendimi i lëshuar më 4 shtator 2012.

³⁸ MAPL nuk e ka bërë ndonjë miratim publik apo formal të udhëzimeve të Komitetit për Komunitete, mirëpo e ka mbështetur hartimin dhe publikimin e tyre në shtator të vitit 2012.

³⁹ Për nenin 53, versioni i gjuhës Shqipe i Ligjit për vetëqeverisje lokale (shënimi 3 më sipër) nuk korrespondon me versionin e gjuhës angleze dhe atë serbe të ligjit, duke dhënë kështu udhëzime të paqarta për atë nëse anëtarët e kuvendit komunal apo anëtarët që i përfaqësojnë komunitetet në pakicë numerike në komunë duhet ta përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit për Komunitete. TR-të për KK-në (shënimi 37 më lart) ndihmon në këtë çështje, duke e theksuar në mënyrë të qartë që anëtarët që i përfaqësojnë komunitetet në pakicë numerike duhet ta përbëjnë shumicën e KK-së (Neni 4).

⁴⁰ Ligji për vetëqeverisje lokale, neni 53, shënimi 3 më sipër.

dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për ta promovuar, shprehur, ruajtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve në komunë”⁴¹. Nuk ka asnjë dispozitë në ligj që tregon për atë se si KK-ja duhet të ndërveprojë me ndonjërin nga tre mekanizmat tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve.

TR-të e KK-së (nenet 5 dhe 7) dhe udhëzimet e KK-së (neni 3 dhe 4) japin shumë më tepër detaje për detyrat dhe përgjegjësitë (si për KK-në në përgjithësi, ashtu edhe për postet e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit), ku përfshihen edhe informata për: rishikimin e buxhetit komunal; dhënien e rekomandimeve për kuvendin komunal dhe kryetarin e komunës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet; avokimin për përfaqësimin e komuniteteve në shërbimin civil të komunës; kanalizimin e kontributeve të komuniteteve në strategji dhe politika përkatëse; dhe monitorimin e raportimin në kuvend komunal si dhe konsultimin dhe bashkërendimin me ZKKK-në, për zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë me komunitetet.

- i. **Raportimi dhe mbikëqyrja.** Ligji nuk përmban ndonjë dispozitë për ndonjë sistem të raportimit dhe mbikëqyrjes së punës së KK-së. Mirëpo TR-të e KK-së e adresojnë çështjen e raportimit, ku theksohet se duhet të ketë së paku raportim çdo gjashtë muaj te kuvendi komunal dhe kryetari i komunës për veprimet, veprimtarinë dhe rekomandimet e KK-së (neni 5.2), si dhe hartimin e raportit vjetor të punës së tij (neni 5.3).

2.2.4 Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK)

ZKKK-ja është mekanizmi me bazën më të detajuar ligjore të zhvilluar përmes bashkëpunimit ndërmjet organeve të nivelit qendror që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjet e komuniteteve (Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Zyra për çështje të Komuniteteve, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe MAPL-ja) si dhe një numër i akterëve ndërkombëtar. Udhëzimi kryesor vjen nga Rregullorja, që është veçanërisht e rëndësishme për themelimin e ZKKK-ve si mekanizëm i unifikuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, ku inkorporohen ish zyrat komunale për komunitete dhe zyrat komunale për kthim. Dokumenti i politikave “Termet e Referencave – Procedurat Standarde të Veprimit për ZKKK-të”⁴², të miratuara nga Grupi punues ndërmintor për ZKKK-të dhe të publikuara në vitin 2011, japin udhëzime shtesë për punën e ZKKK-ve, dhe i detajojnë përgjegjësitë specifike në tri fusha kyçe për të drejtat e komuniteteve: qasjen në shërbime, kthimin dhe riatdhesimin. Përkitazi me katër kriteret e vlerësuara, ato përcaktojnë si në vijim:

- i. **Emërimi dhe përbërja.** Rregullorja jep detaje për postet e parapara në ZKKK, varësisht nga nevojat e një komune të caktuar (ku përfshinë nevojat e identifikuara në bazë të këshillave nga KK-ja): Shefi i zyrës, koordinatori, zyrtari për të drejtat e komuniteteve dhe integrim dhe koordinatori dhe zyrtari për kthim të qëndrueshëm⁴³. Nuk ka

⁴¹ Po aty.

⁴² Termet e Referencës – Procedurat Standarde të Veprimit për ZKKK-të, 21 prill 2011, të qasshme në: http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/ToR_for_MOCRs-20110421-final-eng.pdf (e qasur më 3 maj 2014).

⁴³ Rregullorja e ZKKK-së, nenet 5 dhe 6, shënimi 20 sipër.

dispozita lidhur me proceset e rekrutimit apo kriteret e përzgjedhjes për personelin e ZKKK-së. Mirëpo, kjo zbrazëturë është plotësuar në mënyrë efektive nga TR të ZKKK-së dhe shtojcat e tyre, të cilat i paraqesin përshkrimet e punës për secilën pozitë të specifikuar, si dhe nga Ligji për shërbim civil⁴⁴, i cili i rregullon proceset e emërimit për shërbyesit civil.

- ii. **Synimi dhe Qëllimi.** Ekziston synim i qartë për mekanizmin dhe ai është theksuar në preambulën e Rregullores, që është për të kontribuar në zbatimin e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e komuniteteve të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Kosovë, zbatimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre. Rregullorja gjithashtu thotë që ZKKK-të duhet t'i mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e komuniteteve, sigurojnë qasje të barabartë në shërbime dhe krijojnë kushte për kthim të qëndrueshëm⁴⁵.
- iii. **Mandati dhe përgjegjësitë.** Rregullorja i parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e ZKKK-së si në vijim: të ndërmerr veprime që ndërlidhen me të drejtat e komuniteteve, me theks të veçantë kthimin, procesin e integritetit dhe qasjen në shërbime; të mirëmbajë bazën e të dhënave me informatat për komunitetet e synuara dhe përfituesit; dhe ta kryejë funksionin e bashkërendimit brenda komunës dhe me institucionet relevante qendrore⁴⁶. Për kryerjen e këtyre detyrave dhe përgjegjësisë, Rregullorja kërkon që ZKKK të krijojnë kontakte me përfituesit e synuar (p.sh. pjesëtarët e komuniteteve, të kthyerit, personat e riatdhesuar); të bëjë zhvillimin, monitorimin apo vlerësimin e projekteve nga të cilat përfitojnë komunitetet; të lehtësojë pjesëmarrjen e komuniteteve në zhvillimin e politikave, strategjive relevante dhe planeve të tyre të veprimit; të japë këshilla (me shkrim apo me gojë) për kuvendin komunal apo organet ekzekutive të komunës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve; dhe të ndërmerr aktivitete të kontaktimit dhe vetëdijesimit të publikut⁴⁷.

Rregullorja në mënyrë specifike e thekson që ZKKK duhet të punojë në “bashkërendim të plotë” me mekanizmat tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve; ajo gjithashtu i obligon të gjithë zyrtarët komunalë që të bashkëpunojnë në mënyrë të plotë me ZKKK-në, dhe kërkon që ZKKK të bashkëpunojë me institucionet relevante qendrore⁴⁸.

- iv. **Raportimi dhe mbikëqyrja.** Rregullorja parasheh që ZKKK duhet t'i “raportoje kryetarit të komunës” dhe t'i paraqesë raporte të rregullta të progresit kryetarit të komunës, kuvendit komunal dhe institucioneve qendrore; ajo gjithashtu parasheh që shefi i zyrës, duhet t'i paraqesë raport vjetor kryetarit të komunës dhe kuvendit komunal, dhe të paraqesë raport të detajuar për punën e ZKKK-së në takimin e Komitetit për Komunitete⁴⁹.

⁴⁴ Ligji për shërbimin civil, shënimi 30 më lart.

⁴⁵ Rregullorja e ZKKK-së, neni 1 shënimi 20 më lartë.

⁴⁶ Po aty, neni 7.

⁴⁷ Po aty, neni 8 dhe 9.

⁴⁸ Po aty, neni 4.

⁴⁹ Po aty nenet 3, 7 dhe 8.

2.3 Balanca gjinore

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW)⁵⁰, e cila është drejtpërsëdrejti i zbatueshme në Kosovë⁵¹, kërkon që qeveritë të marrin “të gjitha masat e duhura, përfshirë ato legislative, për të siguruar zhvillim të plotë dhe avancim të grave” dhe “ta sigurojë për gratë në mënyrë të barabartë si për meshkujt të drejtën [...] për pjesëmarrje në formulimin e politikave qeveritare dhe zbatimin e tyre dhe të drejtën për të mbajtur pozita publike dhe kryerje të të gjitha funksioneve publike në të gjitha nivelet e pushtetit”⁵².

Të drejtat e gruas për pjesëmarrjen e barabartë në çështje publike përforcohen më tutje në kornizën ligjore të Kosovës përmes Ligjit për barazi gjinore, i cili përcakton që “pjesëmarrja e barabartë gjinore duhet respektuar në emërimin e anëtarëve të këshillave, komiteteve dhe trupave përfaqësues brenda dhe jashtë Kosovës, nga institucionet kompetente”, duke qartësuar që “pjesëmarrja e barabartë gjinore” konsiderohet të jetë arritur në rastet kur pjesëmarrja në institucione është 40 për qind.⁵³ Përveç këtyre, Ligji për shërbimin civil, që zbatohet për pozitën e NKK-së si dhe për personelin e MKK-së, përfshin përkushtimin e plotë për barazinë gjinore⁵⁴. Derisa korniza ligjore dhe politikat për NKK-të, ZKKKK-të, si dhe ZKKK-të nuk përmbajnë referenca specifike për gjininë, Termat e Referencës si dhe Udhëzimet për komitetet e komuniteteve bëjnë referencë ndaj “trajtimin të barabartë gjinor” si dhe “balancës gjinore” në përbërjen e Komiteteve për Komunitete, respektivisht zgjedhjen e kandidatëve⁵⁵.

2.4 Përmbledhje e gjetjeve

Kur shqyrtohet në lidhje me katër kriteret kryesore (procesi i emërimit dhe përbërjes, qëllimi dhe synimi, mandati dhe përgjegjësia, si dhe raportimi e mbikëqyrja), baza legislative për katër mekanizmat ka një numër mangësish të qarta që ndikojnë në zbatim në nivel lokal. Një përjashtim është Rregullorja e 2012-tës për Zyrat Komunale për Komunitete e Kthim, e cila paraqet përparim të rëndësishëm në heqjen e pasigurisë juridike për së paku njërin prej mekanizmave, siç rekomandohet nga raporti i OSBE-së i vitit 2009.⁵⁶

Derisa proceset e emërimit përshkruhen shkurt, shumica e mekanizmave ende nuk kanë udhëzime për kriteret e kandidatëve, mandatet në detyrë, procedurat e shkarkimit dhe/ose masave për të siguruar transparencën në vendimmarrje. Legjislacioni relevant në

⁵⁰ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 18 dhjetor 1979, e qasshme në: <http://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/cedaë.pdf> (e qasur me 3 maj 2014).

⁵¹ CEDAW është renditur si një ndër instrumentet ndërkombëtare të theksuara në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës dhe është drejtpërsëdrejti i zbatueshme në Kosovë.

⁵² CEDAW, neni 3 dhe 7, përkatësisht, shënimi 50 më sipër.

⁵³ Ligji 2004/02 për barazinë gjinore në Kosovë, 19 shkurt 2004, nenet 3.4, respektivisht 3.2. teksti i plotë në dispozicion tek http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_2_en.pdf (qasur më 3 maj 2014).

⁵⁴ Ligji për shërbimin civil, neni 3.1 si dhe nenet 5, 1.2 dhe 1.9, *supra*, fusnota 30.

⁵⁵ TeR të KK-ve, neni 4.1, *supra*, fusnota 37; Udhëzimet për KK-të, f. 8, *supra*, fusnota 38.

⁵⁶ Raporti i Pjesëmarrjes 2009, f. 27.

fakt përkufizon synimin dhe qëllimin e të katër mekanizmave, por shfrytëzon gjuhë tejet të përgjithshme për mekanizmat e NKK-së dhe KK-së. Ngjashëm, dispozitat ligjore për mandate e përgjegjësi janë të dobëta: këto janë tejet të kufizuara për NKK-të, ZKKKK-të dhe KK-të, si dhe vetëm listohen në formë substanciale për ZKKK-të. ZKKK-ja është i vetmi mekanizëm për të cilin legjislacioni përkufizon marrëdhëniet ndërmjet katër mekanizmave dhe shpjegon hollësitë e raportimit dhe mbikëqyrjes, derisa nuk ka sisteme të tilla të vendosura për NKK, ZKKKK, apo KK.

Hartimi i akteve sekondare, gjegjësisht Udhëzimit Administrativ për NKK-të, Rregullores së ZKKK-ve, si dhe dokumentet e politikave, gjegjësisht termat e referencës dhe udhëzimeve për Komitetet e Komuniteteve, në fakt paraqet përparim të rëndësishëm. Megjithatë, mbesin mangësi të konsiderueshme dhe kontributi i vlefshëm i dhënë nga udhëzimet me politika dëmtohet nga fakti që këto dokumente nuk kanë fuqinë e legjislacionit, gjë që mund të arsyetojë pjesërisht zbatimin e njëjtë (shih pjesën 3). Të dy pozitat e NKK-së dhe ZKKKK-së ndikohen nga një mungesë e hollësive substanciale për përgjegjësitë si dhe për sistemet e raportimit dhe mbikëqyrjes.

Derisa nuk ka ndonjë mostër për struktura ideale të qeverisjes lokale që do të siguronin mbrojtjen dhe promovimin e plotë të të drejtave dhe interesave të komuniteteve, në përputhje me standardet ndërkombëtare, në parim, katër mekanizmat që ekzistojnë në Kosovë duken që do të arrinin të ofronin këtë mbrojtje dhe promovim nëse do të funksiononin mirë. Me Komitetin për Komunitete që është obligativ, si pjesë e degës legjislative të qeverisjes lokale, komunitetet janë të përfshira në vendimmarrje mbi çështjet që i prekin ato në të gjitha komunat, duke përfituar edhe më shumë nga pozita udhëheqëse e ZKKKK-së në disa komuna si dhe kanali për mbrojtjen e të drejtave të garantuara kushtetuese që kjo pozitë e ofron. Ngjashëm, duke punuar si pjesë e degës ekzekutive së qeverisë lokale, ZKKK-ja obligative punon për implementimin e masave praktike, të plotësuara me pozitën udhëheqëse të NKK-së në disa komuna. Megjithatë, mungesa e detajeve në kornizën ligjore dhe në politika dobëson punën e mekanizmave si sistem koherent për implementim në nivel lokal – kjo e njëjta mangësi e detajeve gjithashtu pengon vlerësimin efektiv të funksionimit të tyre në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Zhvillimi i mëtutjeshëm i kornizës ligjore dhe politikave për të katër mekanizmat do të jetë qenësore për përmbushjen e obligimeve nga institucionet e Kosovës.

3. SHQYRTIM I THEMELIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KATËR MEKANIZMAVE

Siç është theksuar më lart, ZKKK-të dhe KK-të janë obligative për të gjitha komunat, pa marrë parasysh madhësinë e popullsisë së komuniteteve në komunë. Pozitat specifike të NKK-së dhe ZKKKK-së kërkohen me ligj vetëm në komunat në të cilat komunitetet përbëjnë së paku ose mbi 10 për qind të gjithë popullsisë së komunës. Sipas regjistrimit të popullsisë të kryer më 2011⁵⁷, ekzistojnë shtatë komuna që obligohen të kenë pozita të NKK-së dhe ZKKKK-së – pra ku numri i komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal është së paku ose mbi 10 për qind.⁵⁸ Megjithatë, duhet theksuar që derisa regjistrimi i vitit 2011 ofron vlerësimin më gjithëpërfshirës dhe të vetmin zyrtar të popullsisë në Kosovë, është raportuar pjesëmarrje e ulët nga disa komunitete, gjegjësisht serbëve, romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës, të cilët mund të jenë përfaqësuar në masë më të vogël.⁵⁹

3.1 Nënkryetari për komunitete

Vlerësimi i themelimit

Në përgjithësi, vlerësimi i OSBE-së ka gjetur që pozitat e NKK-ve janë themeluar në pajtim me legjislacionin përkatës dhe rezultatet e regjistrimit 2011, me përjashtim të komunës së Gračanica/Graçanicës, e cila nuk ka emëruar NKK-në përkundër regjistrimit të mbi 10 për qind të banorëve nga komunitetet në pakicë numerike në nivel komunal. Është inkurajues – si dhe në përputhje me rekomandimet e OSBE-së më 2009⁶⁰ – fakti që tetë komuna⁶¹ kanë shkuar përtej obligimit ligjor, duke themeluar pozita të NKK-ve përkundër faktit që popullata e komuniteteve nuk është vlerësuar nga regjistrimi i vitit 2011 të ketë arritur pragun prej 10 për qind. Prej 14 NKK-ve të emëruar⁶², pesë ishin shqiptarë (në rastin e Lipjanit, nga komuniteti në shumicë numerike në këtë komunë), katër ishin serbë, dy boshnjakë, dy turq, si dhe njëri malazez.⁶³

⁵⁷ Raporti i regjistrimit 2011 mund të gjendet tek: <http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Report%20On%20Population,%20Households%20And%20Housing%20%20Census%20In%20Kosovo%202011.pdf> (qasur më 3 maj 2014).

⁵⁸ Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Graçanicë, Klokot-/Kllokot-, Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë dhe Prizren.

⁵⁹ Për shembull, shih “Komunitetet pakicë në rezultatet e regjistrimit 2011 në Kosovë: Analiza dhe Rekomandime” (Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (ECMI), Raport i Politikave të Kosovës, 18 dhjetor 2012, në dispozicion tek: http://www.ecmikosovo.org/wp-content/Publications/Policy_briefs/2012-12_ECMI_Kosovo_Policy_Brief_-_Minority_Communities_in_the_2011_Kosovo_Census_Results_Analysis_and_Recommendations/eng.pdf (qasur më 3 maj 2014).

⁶⁰ Raporti i pjesëmarrjes 2009, Rekomandimet, f. 27.

⁶¹ Gjilan/Gnjilane (shih fusnotën 62 si më poshtë), Kamenicë/Kamenica, Lipjan/Lipljan, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć dhe Ranilug/Ranillug.

⁶² Vëreni që pozita e ZKK-së në Gjilan/Gnjilane u lirua më 17 tetor 2013, si dhe mbeti e tillë deri në zgjedhjet e muajit vijues. Duke marrë parasysh që shkarkimi kishte ndodhur mu në përfundim të periudhës 18-mujore të vlerësimit, kjo pasqyrë dhe analizë përfshin edhe monitorimin nga OSBE-ja të pozitës së ZKK-së në Gjilan/Gnjilane, si dhe përgjigjet e ish-të emëruarit në pyetësor.

⁶³ Shih Shtojcat 1 dhe 2.

Monitoruesit e OSBE-së kanë raportuar që pagat dhe mëditjet për NKK-të dukej se bëheshin në mënyrë korrekte dhe të rregullt, si dhe që NKK-të kishin qasje në resurset komunale që nevojiteshin për punën e tyre (p.sh. kompjuterë, hapësirë zyre, telefona, transport, etj.). Korniza ligjore dhe e politikave nuk specifikon ndarjen e resurseve specifike buxhetore për NKK-të, për të financuar aktivitetet si të tilla, megjithatë, në së paku katër raste, OSBE-ja ka gjetur që NKK-të kishin qasje në fonde të veçanta apo një buxhet specifik përmes zyrës së kryetarit të komunës. Monitoruesit e OSBE-së gjithashtu kanë gjetur që asnjë komunë nuk ka miratuar terma të referencës apo përshkrimin e punës veçanërisht për pozitën e nënkryetarit; ngjashëm, asnjë NKK nuk ka hartuar apo miratuar planin e punës apo të aktiviteteve.

Vlerësimi i punës

Në përgjithësi, vlerësimi nga OSBE-ja ka gjetur që NKK-të punonin në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Edhe pse në këtë rast mangësitë ekstreme të hollësive në Ligj kufizojnë vlerësimin përmbajtjesor,⁶⁴ monitorimi i OSBE-së konfirmoi që 14 NKK-të e emëruar kryenin së paku përgjegjësitë e tyre themelore të nënkuptuara, për aq sa kanë qëndruar në zyrat e tyre dhe kanë marrë pjesë në mbledhjet e rregullta, duke përfshirë mbledhjet e kuvendit komunal.

Çështjet shqetësuese

Raportimi. Ligji nuk përcakton ndonjë raportim specifik që duhet bërë nga NKK-të, megjithatë kjo është përgjegjësi standarde e të gjithë shërbyesve civilë⁶⁵, si dhe është me rëndësi për llogaridhënie dhe transparencë në punën e NKK-ve. Monitorimi i OSBE-së ka konfirmuar që vetëm katër nga 14 NKK-të e emëruar raportonin mbi punën e tyre, kryesisht përmes raportimit verbal ose përmes raporteve të shkruara e të papublikuara tek kryetari i komunës.

Bashkëpunimi i brendshëm në mbrojtje dhe promovim të të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Shumica e NKK-ve të anketuar nga monitoruesit e OSBE-së shprehnin që komunikimi i tyre me komunën përkatëse ishte i mirë, ndërsa vetëm dy thonin të kenë pasur probleme në praninë të informatave të mirëfillta dhe me kohë⁶⁶. Monitoruesit e OSBE-së vlerësuan që mbi gjysma e NKK-ve (tetë) efektivisht bashkëpunonin me mekanizmat tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve.⁶⁷ Nga trembëdhjetë NKK të anketuar, shumica (11) ndjenin që ka bashkëpunim të mirë ndërmjet katër mekanizmave, edhe pse dy prej tyre raportuan që bashkëpunimi ishte i dobët.⁶⁸

⁶⁴ Vlerësimi i kryer gjatë periudhës së prillit 2012 dhe tetorit 2013 nuk ka vlerësuar punën e ZKK-së kundrejt përgjegjësive të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 2014/01 (*supra*, fusnota 22), pasi që ky i fundit është miratuar në janar të vitit 2014.

⁶⁵ Neni 5, Parimet themelore të shërbimit civil, 1.5 "Përgjegjësia - Nëpunësit civilë janë të detyruar që të raportojnë, shpjegojnë dhe të përgjigjen për pasojat e vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve të tyre administrative", Ligji për shërbimin civil, *supra*, fusnota 30.

⁶⁶ Shih Shtojcën 5.

⁶⁷ Për qëllimet e vlerësimit, "bashkëpunimi efektiv" është definuar si "këmbim i rregullt dhe i suksesshëm i informatave, takimet e përbashkëta, veprimet e koordinuara, përkrahja e ndërsjellë për avokim/lobim për politika apo vendime brenda komunës, etj."

⁶⁸ Shih Shtojcën 5.

Respektimi i gjuhëve. Monitoruesit e OSBE-së raportojnë që vetëm katër pozita të NKK-ve ishin ndikuar në masë të konsiderueshme nga dështimet e komunës në zbatim të obligimeve gjuhësore, kryesisht në lidhje me përdorimin e gjuhës turke apo boshnjake. Përgjigjet në anketë të mbledhura nga NKK-të konfirmonin këtë pasqyrë pozitive në masë të arsyeshme, si dhe asnjëri nuk raportojnë probleme qenësore me përdorimin e gjuhëve.⁶⁹

3.2 Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete

Vlerësimi i themelimit

Pozita e ZKXXX-ve është themeluar në të shtatë komunat ku 10 për qind apo më shumë të popullsisë e përbëjnë komunitetet në pakicë numerike (sipas regjistrimit të vitit 2011).⁷⁰ Tetë komuna të tjera kanë themeluar pozita të ZKXXX-ve përkundër faktit që nuk është arritur pragu prej 10 për qind, edhe pse një prej këtyre pozitave ka qëndruar e lirë që prej dorëheqjes së ZKXXX-së në shtator 2012.⁷¹ Siç kërkohet, të gjithë ZKXXX-të e emëruar vinin nga komunitetet në pakicë numerike në komunën përkatëse. Nga 14 ZKXXX-të në pozitat e tyre në tetor të vitit 2013, tre ishin shqiptarë, tre boshnjakë, tre egjiptian, tre turq dhe dy serbë.⁷²

Monitoruesit e OSBE-së raportojnë që pagesat e pagave dhe mëditjeve për NKK-të dukeshin të jenë bërë në mënyrë korrekte dhe rregullisht, si dhe që në përgjithësi kanë pasur qasje të mirë në resurset e nevojshme për punën e tyre, edhe pse janë raportuar probleme në katër raste në kuptimin e mungesës së zyrave, si dhe qasjen në kompjuterë e telefona. Derisa korniza ligjore dhe politikat nuk specifikojnë ndarjen e resurseve specifike buxhetore për ZKXXX-të për të financuar aktivitetet si të tilla, në gjashtë raste ata kanë pasur mundësi të qasen në fonde përmes buxhetit të kuvendit komunal, ose zyrtarit kryesor financiar të komunës.

Vlerësimi i punës

Në përgjithësi, monitoruesit e OSBE-së kanë gjetur që ZKXXX-të dukeshin të kenë vepruar në pajtim me përgjegjësitë e tyre ligjore, p.sh. pjesëmarrja në mbledhjet e kuvendit komunal; vetëm në një rast kjo nuk ka ndodhur, për shkak të lirit të pozitës. Në tri raste, janë hartuar apo miratuar terma të referencës apo përshkrim i punës nga komuna për këtë pozitë, si dhe në dy raste, janë hartuar apo miratuar plane të punës apo të aktiviteteve.

Çështjet shqetësuese

Raportimi. Ligji nuk kërkon ndonjë raportim specifik nga ZKXXX-të, megjithatë kjo është përgjegjësi standarde e të gjithë shërbyesve civilë, si dhe është me rëndësi për

⁶⁹ *Ibid.*

⁷⁰ Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanice, Klokot/Kllokot, Novobërdë/Novo Brdo, Prizren dhe Štrpce/Shtërpce.

⁷¹ Gjakovë/Đakovica, Gjiilan/Gnjilane, Istog/Istok, Kamenicë/Kamenica, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Mitrovicë/Mitrovica dhe Ranilug/Ranillug (edhe pse kjo pozitë është lënë e lirë pas dorëheqjes në shtator të vitit 2012).

⁷² Shih Shtojcat 1 dhe 2.

Ilogaridhënie dhe transparencë në punën e ZKKKK-ve. Monitorimi i OSBE-së ka konfirmuar që vetëm dy nga 14 ZKKKK-të e emëruar raportnin mbi punën e tyre; kjo bëhen në formë verbale në një rast, si dhe tek kryetari i komunës në një rast tjetër.

Bashkëpunimi i brendshëm në mbrojtje dhe promovim të të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Shumica (dhjetë) e ZKKKK-ve të anketuar nga monitoruesit e OSBE-së shprehnin që komunikimi i tyre me komunën përkatëse ishte i mirë, ndërsa asnjëri nuk thoshte të ketë pasur probleme në pranim të informatave të mirëfillta.⁷³ Monitoruesit e OSBE-së kishin vlerësuar që 11 ZKKKK kanë bashkëpunim efektiv me mekanizmat tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve⁷⁴, si dhe shumica (11) e ZKKKK-ve të intervistuar ndjenin që kishte bashkëpunim të mirë ndërmjet katër mekanizmave,⁷⁵ edhe pse janë raportuar disa probleme me ndarjen e informatave në këtë drejtim.

Respektimi i të drejtave gjuhësore. Monitoruesit e OSBE-së kanë raportuar probleme të konsiderueshme apo çështje në lidhje me përdorimin e gjuhëve në përdorim zyrtar vetëm në lidhje me një pozitë të ZKKKK-së; ZKKKK-të tjerë të intervistuar konfirmonin konkludimin përgjithësisht pozitiv të monitoruesve të OSBE-së që shumica e ZKKKK-ve nuk përballen me probleme për shkak të dështimit nga komunat në respektim të obligimeve në përdorim të gjuhëve⁷⁶.

3.3 Komitetet për Komunitete

Vlerësimi i themelimit dhe përbërjes

Nga 34 komunat e anketuara, monitoruesit e OSBE-së kanë gjetur që të gjitha kanë themeluar komitete të tilla, si dhe që shumica ishin përgjithësisht në përputhje me kornizën ligjore. Vetëm tre komitete janë vlerësuar të kenë probleme serioze në funksionim, ose duke dështuar në mbajtjen e takimeve⁷⁷ ose duke mos pasur përfaqësues të komuniteteve⁷⁸. Megjithatë, kur anëtarësia e KK-ve është vlerësuar kundrejt regjistrimit të popullsisë më 2011, të gjithë komitetet kishin mungesë të përfaqësuesve nga komunitetet e regjistruara si banorë të komunës në regjistrim; gjithsesi, pa marrë parasysh madhësinë e komunitetit të regjistruar, një përfaqësues i tij kërkohet nga ligji në këtë komitet.

34 KK-të e themeluara kishin gjithsej 230 anëtarë. Përgjithësisht, masa më e madhe e anëtarëve të komiteteve ishin shqiptarë (102), pasuar nga serbët (50), ashkallitë (21) si dhe romët (20), e pas tyre, edhe komunitetet tjera të Kosovës me dhjetë apo më pak anëtarë në Komitete në gjithë Kosovën. Analiza e anëtarëve “të munguar” të Komiteteve (që do të thotë anëtarë nga komunitetet që do të duheshin përfaqësuar në KK sipas regjistrimit të vitit 2011, por që nuk janë) tregon që boshnjakët dhe turqit ishin më të prekurit, duke munguar nga KK-të në 23, respektivisht 20 komuna, përkundër pranisë së tyre të regjistruar në ato komuna; egjiptianët dhe goranët qenë të papërfaqësuar në 15,

⁷³ Shih Shtojcën 5.

⁷⁴ *Sipër*, fusnota 67.

⁷⁵ Shih Shtojcën 5.

⁷⁶ *Po aty*

⁷⁷ Kaçanik/Kaçanik.

⁷⁸ Hani i Elezit/Elez Han, që është tërësisht shqiptar; si dhe Parteš/Partesh, që është tërësisht serb.

respektivisht 14 komuna ku ata jetojnë; ashkallitë ishin të papërfaqësuar në 13 komuna ku ata banojnë; si dhe serbët e romët ishin të papërfaqësuar në komitetet e tetë komunave ku ata banojnë.⁷⁹

Në të gjitha rastet, me përjashtim të njërit⁸⁰, kuvendet komunale kishin miratuar statutet e tyre komunale duke përcaktuar funksionimin e komiteteve, si dhe në shtatë raste, kuvendet komunale kanë miratuar edhe termat e referencës për të drejtuar më tutje punën e komiteteve⁸¹. Sa i përket nominimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të komiteteve, kryesuesi dhe zëvendëskryesuesit të komitetit për komunitete, procedurat e mirëfillta⁸² janë respektuar në 23 raste, edhe pse monitoruesit e OSBE-së kanë identifikuar probleme në nëntë raste⁸³.

Monitoruesit e OSBE-së kanë gjetur që pagat apo mëditjet duket të jenë bërë në mënyrë të rregullt dhe korrekte për anëtarët e komiteteve (sipas statuteve të miratuara komunale) në shumicën e rasteve (29), por kanë raportuar probleme specifike në tri komuna⁸⁴. Qasja në resurse adekuate komunale për mbështetjen e punës së komiteteve (si transporti, kompjuterët, telefonat dhe zyrat, etj.) duken të jenë më problematike: Monitoruesit e OSBE-së kanë gjetur që katër komitete⁸⁵ kishin qasje të pjesshme në ato resurse, si dhe që 12 komitete⁸⁶ nuk kishin qasje të tillë. Derisa komitetet në përgjithësi nuk kanë linjë të veçantë buxhetore për aktivitete, në dy raste⁸⁷ ata kanë pasur qasje në financa komunale shtesë përtej minimumit funksional (mëditjet, materialet e zyrës, etj.).

Vlerësimi i punës

Më pak se gjysma e KK-ve të themeluara (13)⁸⁸ kishin hartuar apo miratuar qoftë plan të posaçëm të aktiviteteve apo të veprimit që plotëson legjislacionin, qoftë TR dhe udhëzime të miratuara nga MAPL. Sidoqoftë, në përgjithësi monitoruesit e OSBE-së kanë vlerësuar që rreth dy të tretat e KK-ve punonin në përputhje me TR-të, duke gjetur që 23 sish i respektonin përgjithësisht ato, shtatë⁸⁹ i respektonin pjesërisht, dhe katër⁹⁰ nuk punonin në mënyrën e duhur.

⁷⁹ Shih shtojcën 3.

⁸⁰ Pejë/Peć.

⁸¹ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Glogoc/Glogovac, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Istog/Istok, dhe Pejë/Peć.

⁸² Siç përshkruhet në termat e referencës së Komitetit, nenet 4.1, 4.2, 4.3 dhe 6, *supra*, fusnota 37.

⁸³ Monitoruesit e OSBE-së kanë vlerësuar që procedurat e nominimit dhe përzgjedhjes nuk janë respektuar plotësisht në Štrpce/Shtërpçë, Partëš/Partesh, Klokot/Klllokot, Junik, Prishtinë/Priština, Lipjan/Lipljan, Obiliq/Obilić, Malishevë/Mališevo dhe Rahovec/Orahovac.

⁸⁴ Dragash/Dragaš, Lipjan/Lipljan, dhe Deçan/Dečane.

⁸⁵ Kaçanik/Kaçanik, Štrpce/Shtërpçë, Mitrovicë/Mitrovica dhe Mamuša/Mamushë/Mamuša.

⁸⁶ Viti/Vitina, Kamenicë/Kamenica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Gračanica/Gračanicë, Obiliq/Obilić, Prizren, Dragash/Dragaš, dhe Rahovec/Orahovac.

⁸⁷ Pejë/Peć dhe Shtime/Štimlje.

⁸⁸ Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Glogoc/Glogovac, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Vushtrri/Vučitrn, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Malisevo dhe Prizren.

⁸⁹ Hani i Elezit/Elez Han, Skenderaj/Srbica, Mitrovicë/Mitrovica, Deçan/Dečane, Gjakovë/Đakovica, Junik dhe Dragash/Dragaš.

⁹⁰ Kaçanik/Kaçanik, Obiliq/Obilić, Mamuša/Mamushë/Mamuša dhe Rahovec/Orahovac.

Për të siguruar një pasqyrë më të hollësishme të punës, monitoruesit e OSBE-së kanë identifikuar disa detyra themelore që rrjedhin nga korniza ligjore dhe e politikave, për qëllime të vlerësimit të punës së KK-ve gjatë periudhës 18-mujore prej prillit 2012 deri në tetor 2013. Duke gjetur që prej dy të tretave deri tri të katërtat e tërë KK-ve punonin më pak seç duhet në një varg fushash kyçe, monitoruesit e OSBE-së kanë kryer vlerësimin e mëposhtëm:

Detyra themelore	Nr. i KK-ve që janë vlerësuar se e kanë marrë përsipër detyrën vitin e kaluar	Përqindja e ZKKK-ve që janë vlerësuar se po e kryejnë këtë detyrë
Këshillëdhënia rreth mbrojtjes/promovimit të të drejtave të komuniteteve për organet komunale ⁹¹	9 ⁹²	26%
Nxjerrja e rekomandimeve rreth çështjeve specifike që kanë të bëjnë me mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komuniteteve për organet komunale ⁹³	14 ⁹⁴	42%
Shqyrtimi i buxhetit vjetor komunal të vitit të kaluar ⁹⁵	11 ⁹⁶ (Rekomandimet janë dhënë për vetëm 2 raste ⁹⁷)	32%
Avokimi për përfaqësim të barabartë të komuniteteve në shërbimin civil komunal ⁹⁸	8 ⁹⁹	24%
Mundësimi për komunitetet që të marrin pjesë në hartimin e strategjive dhe politikave përkatëse ¹⁰⁰	4 ¹⁰¹	12%
Monitorimi dhe raportimi në kuvend komunal lidhur me zbatimin e projekteve për komunitete ¹⁰²	4 (dhe një tjetër pjesërisht) ¹⁰³	14%
Këshillimi dhe/ose bashkërendimi me ZKKK në lidhje me përzgjedhjen e projekteve që janë në dobi të komuniteteve ¹⁰⁴	15 ¹⁰⁵	45%

⁹¹ Ligji për vetëqeverisje lokale, neni 53.2, shënimi i 3-të më sipër.

⁹² Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Klokot-/Kllokot-Mitrovicë/Mitrovica, Prizen, Ranilug/Ranillug dhe Vushtrri/Vučitrn.

⁹³ Ligji për vetëqeverisje lokale, neni 53.2, shënimi i 3-të më sipër, dhe TeR-të e KK-së, nenet 5.1, 5.2, 5.3, 7.7, 7.8, 7.9, 7.11, 8.1, 8.2, 8.3, shënimi i 37-të më sipër.

⁹⁴ Ferizaj/Uroševac, Hani i Elezit/Elez Han, Gjilan/Gnjilane, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Deçan/Deçane, Gjakovë /Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo dhe Prizren.

⁹⁵ TeR-të e KK-së, neni 5.2, shënimi i 37-të më sipër.

⁹⁶ Dragash/Dragaš, Hani i Elezit/Elez Han, Gjakovë /Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn.

⁹⁷ Pejë/Peć dhe Skenderaj/Srbica.

⁹⁸ TR-të e KK, neni 5.2, shënimi i 37-të më sipër.

⁹⁹ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Lipjan/Lipljan, Prizren dhe Rahovec/Orahovac.

¹⁰⁰ TeR-të e KK, neni 5.2, shënimi i 37-të më sipër.

¹⁰¹ Vushtrri/Vučitrn, Istog/Istok, Klinë/Klina and Prizren.

¹⁰² TeR-të e KK, neni 5.2, shënimi i 37-të më sipër.

¹⁰³ Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn and Prizren, dhe, pjesërisht, Istogu/Istok partially.

¹⁰⁴ TeR-të e KK, neni 5.2, shënimi i 37-të më sipër.

¹⁰⁵ Kamenicë/Kamenica, NovoBrdo/Novobërdë, Parteš/Partesh, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Deçan/Deçane, Gjakovë /Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Prizren and Rahovec/Orahovac.

Çështjet shqetësuese

Raportimi. Derisa KK-të nuk kanë detyrim ligjor për të raportuar, në TR-të e KK-ve kërkohet që KK-të t'i raportojnë para kuvendit komunal rreth punës së tyre çdo gjashtë muaj dhe të nxjerrin një raport të përvitshëm me shkrim rreth punës për promovimin e të drejtave të komuniteteve¹⁰⁶. Monitoruesit e OSBE-së kanë gjetur që shumë pak nga që të 34 KK-të e themeluara kanë bërë këtë: vetëm shtatë KK kanë raportuar dy herë në vit para kuvendit komunal¹⁰⁷, dhe vetëm nëntë sish kanë përpiluar raport vjetor me shkrim¹⁰⁸.

Bashkëpunimi i brendshëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Shumica e anëtarëve të KK-ve që u anketuan nga monitoruesit e OSBE-së u shprehën se komunikimi mes KK-së së cilës i përkisnin dhe komunës përkatëse ishte i mirë, dhe se u siguroheshin rregullisht dhe në kohë informatat dhe dokumentet e nevojshme, ndonëse rreth një e katërta e të anketuarve raportuan probleme sa i përket procesit.¹⁰⁹ Monitoruesit e OSBE-së kanë vlerësuar që 22 KK po bashkëpunonin në mënyrë efektive me mekanizmat e tjerë të pjesëmarrjes së komuniteteve¹¹⁰, dhe shumica e anëtarëve të anketuar të KK-ve ishin të mendimit që bashkëpunimi mes të katër mekanizmave ishte i mirë¹¹¹. Megjithatë, OSBE ka gjetur që një e treta e KK-ve nuk po bashkëpunonin në mënyrë efektive, dhe përgjigjet e të anketuarve nxorën në pah sfida specifike në këtë kuptim, duke dëshmuar që duhet bërë përmirësime në disa komuna.

Respektimi i të drejtave gjuhësore. Monitoruesit e OSBE-së kanë raportuar vështirësi apo probleme të mëdha përkitazi me përdorimin e gjuhëve në përdorim zyrtar në vetëm pesë KK, derisa tre komitete tjera përballen me probleme më të vogla.¹¹² Rrjedhimisht, problemet lidhur me respektimin e gjuhëve nuk përbënin ndonjë problem të madh për funksionimin e KK-ve, dhe pikëpamjet që anëtarët e KK-ve i ndanë me monitoruesit e OSBE-së e kanë konfirmuar këtë konstatim përgjithësisht pozitiv.¹¹³

3.4 Zyrat komunale për komunitete dhe kthim

Vlerësim i themelimit dhe përbërjes së ZKKK-ve

Qëkurse legjislacioni përkatës ka filluar të zbatohet në vitin 2010, ZKKK-të janë themeluar në 34 komuna.¹¹⁴ Megjithatë, disa syresh nuk janë themeluar në mënyrën e duhur:

¹⁰⁶ TeR-të e KK, nenet 5.2 dhe 5.3, shënimi i 37-të më sipër.

¹⁰⁷ Hani i Elezit/Elez Han, Gllogoc/Glogovac, Gjakovë /Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć dhe Prizren.

¹⁰⁸ Për vitin 2012: Hani i Elezit/Elez Han, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Istog/Istok, Klinë/Klina, Prishtinë/Priština dhe Lipjan/Lipljan.

¹⁰⁹ Shih Shtojcën 5.

¹¹⁰ Shënimi i 67-të më sipër.

¹¹¹ Shih Shtojcën 5.

¹¹² Monitorimi ka identifikuar probleme në NovoBrdo/Novobërdë, Vushtrri/Vučitrn, Junik, Obiliq/Obilić dhe Prizren, dhe problem më të vogla në Štrpce/Shtërpçë, Klinë/Klina dhe Dragash/Dragaš.

¹¹³ Shih Shtojcën 5.

¹¹⁴ Në Malishevë/Mališevo është punësuar vetëm një zyrtar komunal për komunitete dhe kthim në fund të vitit 2012, për të punuar me numrin relativisht të vogël të komuniteteve në pakicë numerike në këtë komunë, të cilat, sipas regjistrimit të vitit 2011 përbënin 0.1% të banorëve të komunës.

monitoruesit e OSBE-së kanë gjetur që 9 ZKKK¹¹⁵ nuk i respektonin kërkesat përkitazi me personelin,¹¹⁶ dhe që 16¹¹⁷ nuk e kishin njohur dhe përfshirë në tërësi ZKKK-në në statutet e tyre, ashtu siç kërkohet me rregullore.¹¹⁸

Shumica e komunave (21) kanë miratuar TR të posaçme dhe e kanë përfshirë ZKKK-në në organigramet e tyre,¹¹⁹ madje rreth gjysma (17) syresh kanë hartuar apo aprovuar edhe një plan aktivitetesh.¹²⁰ Në përgjithësi, monitoruesit e OSBE-së kanë vlerësuar që të gjitha ZKKK-të kishin qasje në burime komunale për qëllime të lehtësimit të punës së vet¹²¹, por, në shtatë raste të ndara, kanë konstatuar që këto burime ishin të pamjaftueshme¹²². Në mënyrë të ngjashme, monitoruesit e OSBE-së kanë vërejtur që duket se të gjitha pagat dhe mëditjet për personelin e ZKKK-ve paguheshin në mënyrë të rregullt, ndonëse personeli u ka bërë të ditura monitoruesve të OSBE-së disa ankesa lidhur me llogaritjen e këtyre pagesave. Në shumicën e rasteve, ZKKK-të kishin qasje në buxhetin apo vijën e vet buxhetore¹²³, me përjashtim të gjashtë rasteve¹²⁴.

Gjithsej 147 punonjës janë të punësuar nëpër ZKKK-të në mbarë Kosovën. Nga ky numër, pjesa më e madhe e punonjësve të ZKKK-ve janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës (56), deri sa të dytët në radhë për nga numri janë punonjësit nga komuniteti shqiptar i Kosovës (33), të pasuar nga komuniteti boshnjak i Kosovës (18), dhe komunitetet ashkali dhe rom të Kosovës (12 dhe 11 përkatësisht), si dhe numër më i vogël i punonjësve nga komunitetet tjera.

Vlerësimi i punës

Në vija të përgjithshme, monitoruesit e OSBE-së kanë vërejtur që shumica e ZKKK-ve punonin në përputhje me kornizën rregullatore dhe planet e punës, duke identifikuar probleme të kësaj natyre në vetëm shtatë sish¹²⁵. Për të siguruar të dhëna më të hollësishme rreth punës së ZKKK-ve, monitoruesit e OSBE-së i kanë identifikuar disa detyra

¹¹⁵ Deçan/Deçane, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Hani i Elezit/Elez Han, Glllogoc/Glogovac, Gračanica/Graçanicë, Malishevë/Mališevo, Podujevë/Podujevo dhe Suharekë/Suva Reka.

¹¹⁶ Rregullorja për ZKKK-të, nenet 5 dhe 6, shënimi i 21-të më sipër.

¹¹⁷ Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Gjakovë /Đakovica, Gračanica/Graçanicë, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Hani i Elezit/Elez Han, Kamenicë/Kamenica, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prizren, Shtime/Štimlje dhe Suharekë/Suva Reka.

¹¹⁸ Rregullorja për ZKKK-të, neni 3.2, shënimi i 21-të më sipër.

¹¹⁹ *Po aty*, neni 10.4: Gjilan/Gnjilane, Glllogoc/Glogovac, Gračanica/Graçanicë, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Istog/Istok, Junik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllkot, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërdë, Obiliq/Obilić, Parteš/Partesh, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn.

¹²⁰ *Po aty*, neni 7.1.4: Glllogoc/Glogovac, Gračanica/Graçanicë, Istog/Istok, Junik, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërdë, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka dhe Vushtrri/Vučitrn.

¹²¹ *Po aty*, neni 10.1.

¹²² Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Glllogoc/Glogovac, Kamenicë/Kamenica, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Podujevë/Podujevo, Prizren dhe Rahovec/Orahovac.

¹²³ Rregullorja për ZKKK-të, neni 10.1, shënimi i 21-të më sipër.

¹²⁴ Deçan/Deçane, Gračanica/Graçanicë, Junik, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša dhe Suharekë/Suva Reka.

¹²⁵ Monitorimi ka identifikuar që ZKKK-të e Deçanit/Deçane dhe Malishevës/Mališevo nuk vepronin në përputhje me Rregulloren 02/2010 apo planin e tyre të punës, ndërsa puna e ZKKK-ve në vijim ishte vetëm pjesërisht në përputhje: Kaçanik/Kaçanik, Hani i Elezit/Elez Han, Mitrovicë/Mitrovica, Prizren dhe Dragash/Dragaš.

themelore që rrjedhin nga korniza legislative dhe e politikave për qëllime të vlerësimit të punës së ZKKK-ve gjatë periudhës 18-mujore nga prilli 2012 deri në tetor 2013. Duke gjetur që, përgjithësisht, mes gjysmës dhe tri të katërtave të ZKKK-ve i zbatojnë shumicën e detyrave që u takojnë me mandate, monitoruesit e OSBE-së kanë kryer vlerësimin që vijon:

Detyra themelore	Nr. i ZKKK-ve që janë vlerësuar se e kanë marrë përsipër detyrën vitin e kaluar	Përqindja e ZKKK-ve që janë vlerësuar se po e kryejnë këtë detyrë
Vendosja e kontakteve me gjithë komunitetet dhe kategoritë e përfituesve (p.sh. të kthyerit, personat e riadhesuar apo rastet sociale në mesin e komuniteteve në pakicë numerike në komunën në fjalë). ¹²⁶	33 <i>(Ndonëse ka pasur disa vërejtje lidhur me kontaktet e pakta me komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës)</i>	100%
Vlerësimi i të drejtave të komuniteteve / nevojave të përfituesve (apo përditësimi i ndonjë vlerësimi të mëhershëm). ¹²⁷	23 ¹²⁸ <i>(Megjithatë, vëreni se vlerësimet kanë qenë shpesh të kufizuara, janë bërë vetëm për komunitete të veçanta, vetëm për grupet e të kthyerve, apo projekte a donatorë të caktuar).</i>	70%
Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me hisedarët përkatës (p.sh. bashkërendimi ndërmjet OJQ-ve, donatorëve dhe përfituesve etj.). ¹²⁹	27 ¹³⁰ <i>(3 vetëm deri në një masë¹³¹)</i>	82%
Përpilimi, monitorimi apo vlerësimi i projekteve që janë në dobi të komuniteteve. ¹³²	15 ¹³³	45%
Lehtësimi i pjesëmarrjes së komuniteteve gjatë hartimit të strategjive/politikave/planeve përkatëse të veprimit. ¹³⁴	10 ¹³⁵	30%

¹²⁶ Rregullorja për ZKKK-të, neni 7, shënimi i 21-të më sipër; TeR-të e ZKKK, Kapitulli II, neni 3.1, shënimi i 42-të më sipër.

¹²⁷ TeR-të e ZKKK, Kapitulli II, neni 3.3, shënimi i 42-të më sipër.

¹²⁸ Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Ranilug/Ranillug, Novo Brdo/Novobërdë, Parteš/Partesh, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Vushtrri/Vučitrn, Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Gračanica/Gračanicë, Obiliq/Obilić, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša dhe Rahovec/Orahovac.

¹²⁹ Rregullorja për ZKKK, neni 4, shënimi i 21-të më sipër; TR-të e ZKKK, Kapitulli II, neni 3.2, shënimi i 42-të më sipër.

¹³⁰ Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Ranilug/Ranillug, Novo Brdo/Novobërdë, Parteš/Partesh, Klokot/Kllokot-, Glogoc/Glogovac, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Gračanica/Gračanicë, Obiliq/Obilić, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Prizren, Dragash/Dragas and Rahovec/Orahovac.

¹³¹ Vushtrri/Vučitrn, Malishevë/Mališevo and Dragash/Dragaš.

¹³² TeR-të e ZKKK, Kapitulli II, neni 3.4, shënimi i 42-të më sipër.

¹³³ Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Parteš/Partesh, Vushtrri/Vučitrn, Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Junik, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Lipjan/Lipljan, Suharekë/Suva Reka dhe Rahovec/Orahovac. Istog/Istok, Klinë/Klina dhe Prishtinë/Priština.

¹³⁴ Rregullorja për ZKKK-të, neni 7, shënimi i 21-të më sipër.

¹³⁵ Ferizaj/Uroševac, Novo Brdo/Novobërdë, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Istog/Istok, Klinë/Klina, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan dhe Prizren.

Monitorimi i politikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komuniteteve apo përfituesve specifikë. ¹³⁶	16 ¹³⁷ (3 vetëm deri në një masë ¹³⁸)	48%
Këshillimi (me shkrim apo verbalisht) i kuvendit komunal apo trupave të ekzekutivit komunal lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komuniteteve. ¹³⁹	15 ¹⁴⁰	45%
Informimi i publikut apo vetëdijesimi i komuniteteve dhe grupeve specifike të përfituesve. ¹⁴¹	22 ¹⁴²	67%

Çështjet shqetësuese

Raportimi dhe transparenca. Monitoruesit e OSBE-së kanë gjetur që nga 33 ZKKK të themeluara, 27 u raportonin rregullisht strukturave komunale ashtu siç kërkohet, përfshirë përmes raporteve vjetore,¹⁴³ megjithëse këto raporte ishin vënë në dispozicion të publikut në vetëm 11 komuna.¹⁴⁴

Bashkëpunimi i brendshëm për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Shumica (71 për qind) e personelit të ZKKK-ve të anketuar nga monitoruesit e OSBE-së janë shprehur që komunikimi i tyre me komunën përkatëse ishte i mirë, dhe që informatat apo dokumentet e nevojshme u siguroheshin në kohë dhe rregullisht, ndonëse rreth një e katërta e të anketuarve raportuan probleme.¹⁴⁵ Në mënyrë të ngjashme, shumica (70 për qind) e personelit të anketuar të ZKKK-ve ishin të mendimit që ka bashkëpunim të mirë me tre mekanizmat tjerë,¹⁴⁶ përfundim ky i mbështetur edhe nga monitoruesit e OSBE-së të cilët gjetën që 24 ZKKK bashkëpunonin në mënyrë efektive¹⁴⁷ me mekanizmat tjerë në komunë. Megjithatë, monitoruesit e OSBE-së kanë vërejtur mungesë të bashkëpunimit të këtillë në gati një të tretën e ZKKK-ve, që do të thotë se ka nevojë të bëhen përmirësime në disa komuna.

¹³⁶ Rregullorja për ZKKK, neni 4, shënimi i 21-të, si dhe Rregullorja e TeR, Kapitulli II, neni 3.5, shënimi i 42-të më sipër.

¹³⁷ Ranilug/Ranillug, Novo Brdo/Novobërdë, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Vushtrri/Vučitrn, Deçan/Dečane, Istog/Istok, Junik, Klinë/Klina, Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Gračanica/Gračanice, Suharekë/Suva Reka, Prizren, Dragash/Dragaš and Rahovec/Orahovac.

¹³⁸ Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo dhe Rahovec/Orahovac.

¹³⁹ Rregullorja për ZKKK, neni 7.1.7, shënimi i 21-të; TeR-të e ZKKK, Kapitulli II, neni 3.6 dhe neni 3.7, shënimi i 42-të më sipër.

¹⁴⁰ Kamenicë/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdë, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Deçan/Dečane, Gjakovë /Đakovica, Istog/Istok, Junik, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Suharekë/Suva Reka, Prizren dhe Rahovec/Orahovac.

¹⁴¹ TeR-të e ZKKK, Kapitulli II, neni 3.8, shënimi i 42-të më sipër.

¹⁴² Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Gjilan/Gnjilane, Ranilug/Ranillug, Parteš/Partesh, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Deçan/Dečane, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Junik, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje, Lipjan/Lipljan, Gračanica/Gračanice, Obiliq/Obilić, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo, Prizren dhe Dragash/Dragaš.

¹⁴³ Rregullorja për ZKKK, neni 7.1.7, shënimi i 21-të më sipër.

¹⁴⁴ Viti/Vitina, Kamenicë/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdë, Glogoc/Glogovac, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Gjakovë/Đakovica, Klinë/Klina, Pejë/Peć dhe Prishtinë/Priština.

¹⁴⁵ Shih Shtojcën 5.

¹⁴⁶ Po aty.

¹⁴⁷ Shënimi i 67-të më sipër.

Respektimi i të drejtave gjuhësore. Monitoruesit e OSBE-së kanë raportuar vështirësi apo probleme sa i përket përdorimit të gjuhëve në përdorim zyrtar në vetëm 5 ZKKK,¹⁴⁸ dhe që, si rrjedhim, respektimi i të drejtave gjuhësore nuk përbën pengesë të madhe ndaj funksionimit të ZKKK-ve; pikëpamjet e mbledhura nga personeli i ZKKK-ve e kanë vërtetuar këtë përfundim përgjithësisht pozitiv¹⁴⁹.

3.5 Balanca gjinore

Në gjithë mekanizmat ka pasur mungesë të balancës në përfaqësim gjinor, gjë që mund të dëmtojë aftësinë e mekanizmave për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë efektive çështjet me të cilat përballen burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat në komunitetet që i përfaqësojnë, e që shpeshherë mund të jenë të natyrave nga më të ndryshmet. Kështu, gjithë mekanizmat duhet të miratojnë masa afirmative për përmirësimin e balancës në përfaqësim gjinor.

Pozitat e NKK-së dhe ZKKKK-së i mbanin thuajse ekskluzivisht meshkujt, nga që vetëm Mamuša/Mamusha/Mamuša dhe Mitrovica/Mitrovica kishin një ZKK dhe ZKKK femër përkatësisht.¹⁵⁰

Derisa zgjedhjet ose emërimet janë ato që përcaktojnë se kush do të përzgjidhet si ZKKKK dhe anëtar i KK-ve, NKK dhe anëtarët e ZKKK-ve punësohen si nëpunës civilë dhe, meqë punësohen si të tillë, për ata ka detyrime të qarta përkitazi me balancën gjinore.¹⁵¹

Ngjashëm, gratë nuk ishin të përfaqësuara sa duhet në shumicën e KK-ve: nga gjithsej 230 anëtarë të KK-ve, vetëm 67 (29 për qind) ishin femra; 20 KK (59 për qind) kishin në përbërje më pak se 40 për qind anëtare femra¹⁵²; dhe gjashtë KK nuk kishin asnjë anëtare femër¹⁵³. Katërbëdhjetë KK (41 për qind) ishin në gjendje pak më të mirë, nga që 40 për qind apo më shumë në radhët e anëtarëve të tyre ishin gra,¹⁵⁴ ndërkaq vetëm katër KK kishin më shumë anëtare femra se meshkuj¹⁵⁵.

¹⁴⁸ Monitorimi ka identifikuar problem në Mitrovicë/Mitrovica, Prishtinë/Priština, Gračanica/Graçanicë, Suharekë/Suva Reka dhe Prizren.

¹⁴⁹ Shih Shtojcën 5.

¹⁵⁰ Shih Shtojcën 2. Fatkeqësisht, e njëjta gjendje pasqyrohet në udhëheqjen komunale anekënd Kosovës madje edhe gjatë periudhës së vlerësimit, për faktin se asnjë komunë nuk ka pasur kryetare apo zëvendëskryetare, dhe vetëm tri gra kanë qenë të emëruara si zëvendëskryesueset të kuvendeve komunale. Në dritën e kësaj gjendjeje, duket se gratë nga komunitetet që janë në pakicë numerike në nivel komunal nuk janë në ndonjë disavantazh më të madh.

¹⁵¹ Siç u përmend më sipër, Ligji nr. 03/L-149 për shërbimin civil, përcakton disa zotime për barazi gjinore, shënimi i 30-të më sipër.

¹⁵² Deçan/Dečane, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Gjiilan/Gnjilane, Gračanica/Graçanicë, Kaçanik/Kaçanik, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Istog/Istok, Junik, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac, Skenderaj/Srbica, Viti/Vitina dhe Vushtrri/Vucitrn.

¹⁵³ Gjiilan/Gnjilane, Gračanica/Graçanicë, Istog/Istok, Junik, Klokot/Kllokot dhe Viti/Vitina.

¹⁵⁴ Dragash/Dragaš, Deçan/Dečane, Gjakovë/Đakovica, Gillogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Kamenicë/Kamenica, Malishevë/Mališevo, NovoBrdo/Novobërdë, Partëš/Partesh, Prizren, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë dhe Suharekë/Suva Reka.

¹⁵⁵ Deçan/Dečane, Dragash/Dragaš, Gillogoc/Glogovac dhe Ranilug/Ranillug.

ZKKK qëndronin më së miri për sa i përket përfaqësimit gjinor, ku nga 147 punonjës, 44 ishin gra (30 për qind). Megjithatë, në nivel individual, vetëm 11 sish kishin personel në përbërje prej 40 për qind e më tepër femra (32 për qind), ndërsa 23 kishin më pak se 40 për qind (68 për qind); për më tepër, 11 komuna nuk kishin asnjë punonjëse femër në ZKKK (32 për qind), ndërsa vetëm dy sish nuk kishin asnjë punonjës mashkull (6 për qind).¹⁵⁶

3.6 Përmbledhje e gjetjeve

Themelimi dhe funksionimi

Vlerësimi i OSBE-së lidhur me përputhshmërinë me kërkesat ligjore për themelimin e katër mekanizmave arriti në përfundimin se situata është përgjithësisht e mirë, ndonëse larg nga të qenit e plotë. Të gjitha pozitat e obligueshme të NKK-ve dhe ZKKKK-ve janë krijuar me përjashtim të Gračanica/Graçanicës. Disa komuna i kanë krijuar pozitat edhe kur ato nuk ishin të detyrueshme, d.m.th ato që kanë më pak se 10 për qind të popullatës së tyre komunitete në pakicë numerike sipas regjistrimit të vitit 2011¹⁵⁷, por që aktorët vendorë ishin të mendimit se këto pozita janë të rëndësishme për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë: tetë pozita NKK dhe tetë (shtatë të plotësuara) pozita ZKKKK. Gjersa vetëm disa pozita ZKKKK janë prekur nga mungesa e burimeve operative, vlerësim i detajuar i performancës së NKK-ve dhe ZKKKK-ve, për fat të keq, nuk ishte i mundur, si pasojë e mungesës së udhëzimeve ligjore apo politikave për mandatet dhe përgjegjësitë e tyre.

Të gjitha komunat kanë themeluar KK dhe ZKKK, me përjashtim të Malishevës, e cila ka emëruar një zyrtar të vetëm në vend të ZKKK-së. Monitoruesit e OSBE-së kanë konstatuar se KK-të në të gjitha komunat nuk kanë arritur t'i përfshijnë përfaqësuesit nga gjitha komunitetet në komunë, gjersa më pak se gjysma e KK-ve kishin qasje në pajisje dhe mjete bazike për punën e tyre, si dhe katër prej tyre nuk funksiononin si duhet. Situata ishte më e mirë për ZKKK-të, ndonëse rreth gjysma e tyre kishin probleme të vogla me vendosje dhe punonjës. Monitoruesit e OSBE-së kanë gjetur se vetëm disa prej tyre kishin mungesa të resurseve adekuate operative. Vlerësimi i OSBE-së për detyrat materiale të KK-ve ka identifikuar probleme të rënda, ku dy të tretat deri tri të katërtat e të gjitha KK-ve kanë pasur performancë më të dobët në një varg fushash kyçe. Mbi tri të katërtat e KK-ve nuk kanë arritur të sigurojnë udhëzime për të drejtat e komuniteteve, të avokojnë për përfaqësim të komuniteteve në shërbimin civil, të lehtësojnë përfshirjen e komuniteteve në hartim të politikave dhe strategjive, apo t'i raportojnë Kuvendeve Komunale për

¹⁵⁶ Shih Shtojcën 4.

¹⁵⁷ Rekomandimi i Komitetit Këshillëdhënës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare që ka të bëjë me interpretimin e të dhënave të censusit 2011 është i rëndësishëm për vendimmarrjen për themelimin e pozitave të ZKK-ve dhe ZKKKK-ve nëse ato nuk janë të obligueshme sipas censusit 2011. "Komiteti Këshillëdhënës [...] konsideron se duhet të aplikohet një shkallë fleksibiliteti në analizimin dhe përpunimin e rezultateve të censusit, veçanërisht për sa i përket të drejtave të komuniteteve pakicë të cilat bazohen në numrat e tyre në një komunë të caktuar." Shih Opinionin e Tretë për Kosovën, të miratuar më 6 mars 2013, Këshilli i Evropës, f. 13, paragrafi 29. Në dispozicion në: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_FCNDocs/PDF_3rd_OP_Kosovo_en.pdf (qasur më 3 maj 2014).

projektet përkatëse. ZKKK-të kanë pasur performancë më të mirë në një vlerësim të ngjashëm të OSBE-së të detyrave të tyre thelbësore, ku ndërmjet gjysmës dhe tri të katërtave të ZKKK-ve i kanë realizuar shumicën e detyrave të tyre të mandatuara. Megjithatë, një e treta deri te gjysma e ZKKK-ve nuk kanë arritur të realizojnë projekte apo politika për monitorimin e lehtësimin e përfshirjes së komuniteteve në hartim të strategjive apo politikave, apo këshillimin e komunës.

Në aspekt pozitiv, gjersa vetëm ZKKKK ka mandat specifik për të punuar në dialogun ndërmjet komuniteteve, ky vlerësim tregon se të katër mekanizmat kanë një rol potencialisht të rëndësishëm në nxitjen e marrëdhënieve të mira dhe komunikimit. Gati dy të tretat e të anketuarve mendonin se katër mekanizmat kanë dhënë kontribut pozitiv në përmirësimin e marrëdhënieve, ndërsa të anketuarit kanë theksuar se vetë ekzistenca e mekanizmave ka ndihmuar në rritjen e komunikimit dhe besimit ndërmjet. Ngritja e kapaciteteve dhe investimet e mëtejshme në këtë fushë me siguri do të ishin produktive.

Çështjet shqetësuese

Ky vlerësim ka vënë në pah një numër çështjesh shqetësuese. Në anën pozitive, duket se përputhshmëria gjuhësore ishte përgjithësisht e mirë, ndonëse me disa probleme të vogla por serioze të identifikuar që kanë ndikim në punën e katër mekanizmave në një numër të vogël të komunave. Më shqetësuese është se disa nga mekanizmat kishin mungesë të mekanizmave të qarta të raportimit dhe mbikëqyrjes: vetëm katër NKK dhe dy ZKKKK kanë paraqitur raporte për punën e tyre (shpeshherë vetëm gojarisht) dhe më pak se një e treta e KK-ve kanë raportuar rregullisht; gjersa 27 nga 33 ZKKK kanë raportuar rregullisht, vetëm një e treta e raporteve të tyre ishin në dispozicion publik. Përderisa MAPL bën monitorim¹⁵⁸, ai duhet të fuqizohet për të përfshirë më shumë detaje për funksionimin dhe performancën e NKK-ve, ZKKKK-ve dhe KK-ve në veçanti, si dhe veprime përcjellëse për trajtimin e rasteve specifike të mospërputhshmërisë. Ekziston nevoja që institucionet qendrore ta zhvillojnë rolin e tyre në këtë drejtim, si në promovimin e raportimit më të madh dhe më transparent nga vetë mekanizmat, ashtu edhe në sigurimin e mbikëqyrjes përmes monitorimit të performancës së mekanizmit.

Raportimi transparent për aktivitetet është i lidhur me bashkëpunimin efektiv ndërmjet mekanizmave dhe funksionimin e tyre si një sistem i kombinuar për komunitete në nivelin komunal. Një e katërta e të anketuarve të KK-ve dhe ZKKK-ve kanë raportuar probleme me pranimin e informatave të plota dhe në kohë të duhur nga komuna dhe një e pesta e të gjithë të anketuarave kanë dhënë vlerësim negative për bashkëpunimin ndërmjet mekanizmave. Krahasimi i këtyre përgjigjeve me vlerësimin e OSBE-së (që ka gjetur se

¹⁵⁸ Departamenti i Monitorimit i MAPL-së bën monitorim të rregullt të pushtetit lokal në Kosovë, duke hartuar një varg raportesh. Gjersa tre raporte të monitorimit të publikuar deri më sot mbulojnë krijimin e KK-ve dhe ZKKK-ve, dhe mbledhin të dhëna themelore si numri i takimeve në vit, ato nuk hyjnë në detaje për funksionimin e tyre. Shih: *Raporti për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës, janar-qershor 2012*, MAPL korrik 2012, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/3b6729f0-1175-40b8-9e28-6ca8d782d035/Report-of-functioning-of-Municipalities-of-the-Rep.aspx>; *Raport për monitorimin e Komunave të Republikës së Kosovës, janar-dhjetor 2012*, shkurt 2013, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/949c9281-1b66-463a-9244-25ebf002fb61/Raport-i-Monitorimit-te-Komunave-te-Republikes-se.aspx>; dhe, *Raport për funksionimin e kuvendeve komunale të Republikës së Kosovës, janar-korrik 2013*, MAPL qershor 2013, <https://mapl.rks-gov.net/Raporte/2013.aspx> (të gjitha të qasura më 3 maj 2014).

vetëm gjysma e NKK-ve dhe dy të tretat e ZKKKK-ve, KK-ve dhe ZKKK-ve kanë bashkëpunim efektiv¹⁵⁹ me mekanizma të tjerë) tregon se janë një numër komunash që kanë probleme serioze në këtë fushë. Vlerësimet e OSBE-së tregojnë se bashkëpunimi është faktor kyç në arritjen e suksesit,¹⁶⁰ korrelacion ky i mbështetur nga përgjigjet e anketës, që nënvizonin se bashkëpunimi i brendshëm ndërmjet katër mekanizmave është element i rëndësishëm i lobimit efektiv për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Shumica e komunave nuk kishin sisteme formale për bashkërendim apo këmbim të informatave ndërmjet mekanizmave dhe është e qartë që kjo është fushë e rëndësishme për përmirësim.

Ky bashkëpunim dhe kjo mbështetje reciproke me gjasë janë veçanërisht të rëndësishme duke pasur parasysh përvojat e shumë të anketuarve me mungesë të prioritetit apo mungesë të mbështetjes nga aktorët komunalë për çështje të komuniteteve, gjë që e kanë identifikuar si pengesë të rëndësishme për suksesin. Shumë të anketuar mendonin se katër mekanizmat në masë të madhe injoroheshin apo anashkaloheshin nga vendimmarrësit komunalë, se mekanizmat kishin mungesë të mbështetjes (apo ishin thellësisht të varur) nga sponsorë të fuqishëm, dhe se tendenca ishte që të mbizotëronin interesat e pjesëtarëve të komuniteteve në shumicë numerike në disa komuna. Ky problem është theksuar edhe nga vetë MAPL,¹⁶¹ dhe është identifikuar në raportin e OSBE-së më 2009 që theksonte “mungesën e fuqizimit të përfaqësuesve të komuniteteve nga udhëheqësit komunalë”¹⁶². Raporti i vitit 2009 gjithashtu ka theksuar një tjetër problem të cilin e kanë identifikuar përsëri përgjigjet në anketë, gjegjësisht se interesat e partive politike kanë ndikim në punën e mekanizmave, ku disa herë marrin peshë më të madhe se interesat e komuniteteve¹⁶³; është gjithashtu shqetësuese se përgjigjet tregojnë se kjo gjithashtu ka komprometuar procesin e përzgjedhjes për punësim apo asistencë komunale. Trajtimi i të dy këtyre çështjeve kërkon ndryshme në qëndrime dhe kulturën profesionale tek stafi komunal dhe liderët në përgjithësi, por bashkëpunimi ndërmjet të katër mekanizmave do të jetë thelbësor në fuqizimin e zërave të tyre të kombinuar.

Një tjetër fushë shqetësuese është përfaqësimi i komuniteteve dhe grave në mekanizma. Siç është theksuar më sipër, balanca gjinore në mekanizma NKK, ZKKKK dhe KK ishte shumë i dobët: përfaqësimi i pakët i grave paraqiste pengesë të rëndë në përfaqësimin efektiv të interesave dhe shqetësimeve të grave dhe vajzave. Kur janë pyetur për

¹⁵⁹ Shih *shënimin më sipër* 67.

¹⁶⁰ Për qëllime të hulumtimit, “suksesi” është përkufizuar si sukses në punën në një çështje të caktuar që lidhet me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë (f.sh. mekanizmi ka kërkuar veprim ose vendim që është ndërmarrë, ose ka pasur sukses në bllokimin e një veprimi ose vendimi problematik). Gjatë periudhës së vlerësimit prill 2012-prill 2013, monitoruesit e OSBE-së kanë konstatuar: nga shtatë KK që nuk bashkëpunonin në mënyrë efektive me mekanizmat e tjerë, asnjë nuk kishte përjetuar sukses; nga shtatë ZKKK që nuk kishin bashkëpunim efektiv, vetëm një u vlerësua se ka arritur sukses; nga katër ZKKKK që nuk kishin bashkëpunim efektiv, asnjë nuk është vlerësuar të ketë pasur ndonjë sukses; ndonëse, nga katër ZKKKK që nuk kishin bashkëpunim efektiv, tre kishin përjetuar një shkallë suksesi.

¹⁶¹ Një raport monitorimi i MAPL-së 2012 ka theksuar se, “Ndonëse komitetet e obligueshme janë të detyrueshme sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat i kushtonin më pak vëmendje Komitetit për Komunitete. Mund të themi se ky komitet është më shumë përmbushje formale e nxjerrë nga obligimi ligjor”. f. 8, *Raport për funksionimin e komunave – janar – qershor 2012*, MAPL korrik 2012, *shënimi më sipër* 158.

¹⁶² Raporti për Pjesëmarrjen 2009, f. 25 dhe f. 27.

¹⁶³ Po aty, f. 25.

përfaqësimin e drejtë të të gjitha komuniteteve në mekanizma (pavarësisht lidhjes individuale me komunitetin të atyre të emëruar), vetëm një e pesta e të anketuarve mendonin se përfaqësimi nuk ishte i drejtë. Të anketuarit kanë theksuar një numër problemesh të perceptuara, duke përfshirë që komuniteti serb në Kosovë gëzon prioritet më të madh gjersa komunitetet më të vogla lihen anash dhe se disa NKK dhe ZKKKK i shërbejnë vetëm komunitetit të tyre.

4. PËRFUNDIME

Përbushja e së drejtës së komuniteteve për pjesëmarrje në qeverisjen lokale në Kosovë varet në masë të madhe në funksionimin e katër mekanizmave të krijuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve: Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), Komitetet për Komunitete (KK), si dhe pozitat e Zëvendëskryetarit të Komunës për Komunitete (NKK) dhe Zëvendës-Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete (ZKKKK).

Raporti i vitit 2009 i hartuar nga OSBE-ja arriti në përfundimin se duhet të ndërmerren hapa të mëtejme legjislativë, dhe se duhet të vihet një theks më i madh në zbatim meqë “mekanizmat ekzistues jo gjithmonë iu ofrojnë komuniteteve mbrojtje të vërtetë dhe efektive, apo garantim të pjesëmarrjes së tyre”¹⁶⁴. Katër vite më vonë, ky raport – ndonëse duke pranuar se është arritur një përparim i rëndësishëm dhe i konsiderueshëm – e përsëritë po këtë gjetje, dhe konkludon që janë një numër dështimesh kyçe që duhet të trajtohen në mënyrë që institucionet e Kosovës të sigurojnë pjesëmarrje efektive në qeverisjen lokale.

Zbrazëtitë e konsiderueshme në kuadrin ligjor ndikojnë negativisht në aftësinë e institucioneve të Kosovës për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe interesat e komuniteteve në përputhje me standardet ndërkombëtare. Mungesa e akteve të detajuara nënligjore për Ligjin për Vetëqeverisje Lokale i ka lënë vendimmarrësit dhe palët e interesuara në mungesë të udhëzimeve të sakta për çështjet praktike të veprimtarisë dhe funksionimit të tre nga katër mekanizmat. Gjersa hartimi i dokumenteve të politikave ofron udhëzime shtesë për punën e KK-ve, ato nuk e kanë fuqinë e legjislacionit. Prandaj, inkorporimi i elementeve kyçe të atyre udhëzimeve të politikave në akte nënligjore do të jetë vendimtar për të siguruar që funksionimin efektiv të mekanizmave dhe përputhshmërinë e tyre me kuadrin ligjor.

Në të njëjtën mënyrë, gjersa Udhëzimi i ri Administrativ i miratuar në janar të vitit 2014 është hap pozitiv, janë të nevojshme akte më të hollësishme nënligjore dhe udhëzime të politikave për pozitat e NKK-ve dhe ZKKKK-ve. Një kornizë e qartë ligjore për funksionimin e tyre do të bënte ndryshim të rëndësishëm edhe për cilësinë e performancës së tyre edhe për mundësinë për ta vlerësuar performancën e të emëruarve. Aktet nënligjore gjithashtu duhet të përshkruajnë sisteme transparente dhe domethënëse të raportimit dhe mbikëqyrjes për të gjitha mekanizmat, duke përfshirë një rol monitorues për

¹⁶⁴ Po aty., f. 25.

institucionet qendrore.¹⁶⁵ Në përgjithësi, korniza ligjore dhe e politikave nuk ka arritur t'i përvijojë modalitetet për funksionimin e përbashkët të të katër mekanizmave si sistem koherent për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në nivelin lokal.

Në përgjithësi, përputhshmëria me kërkesat ekzistuese ligjore për themelimin e katër mekanizmave ishte e mirë, ndonëse jo e plotë. Ndonëse janë themeluar pothuajse të gjithë mekanizmat e obligueshëm, si dhe disa pozita jo të obligueshme, ende kanë mbetur disa probleme. Një pozitë e obligueshme NKK nuk është krijuar dhe një pozitë për ZKKKK ka qenë e lirë për më shumë së një vit; asnjë nga KK-të nuk kishin anëtarësi të plotë që përmbush obligimin për përfshirjen e të gjitha komuniteteve që banojnë në fushat e tyre komunale; disa ZKKK kishin mungesë stafi; dhe një numër komunash nuk arritën t'i aprovonin statutet e plota për ZKKKK-të, sipas Rregullores. Vlerësimet e funksionimit të mekanizmave ishin larg nga të qenit pozitivë. Dy të tretat deri tri katërtat e të gjitha KK-ve janë vërejtur të kenë performancë më të dobët në disa fusha kryesore; dhe një e katërta deri gjysma e ZKKK-ve kishin dështuar në zbatimin e detyrave të tyre të mandatuar.

Fatkeqësisht, nuk ishte e mundur të kryhej një vlerësim i hollësishëm i performancës së NKK-ve dhe ZKKKK-ve, për shkak të mungesës së hollësive në kuadrin ligjor lidhur me mandatet dhe përgjegjësitë e tyre. Monitorimi i OSBE-së gjithashtu ka identifikuar udhëzime dhe performancë joadekuate për raportimin dhe mbikëqyrjen, si dhe bashkëpunim të dobët të brendshëm ndërmjet mekanizmave.

Të gjithë mekanizmat gjithashtu kishin përfaqësim shumë të dobët të grave. Anketa me të intervistuarit nga mekanizmat ka identifikuar një numër çështjeve të tjera, duke përfshirë mos-çaktimin si prioritet të funksionimit të mekanizmave nga aktorë të tjerë komunalë, ndikimin e partive politike, si dhe perceptimin se mekanizmat shpeshherë anashkalojnë interesat e komuniteteve më të vogla. Në anën pozitive, hulumtimi ka treguar se dështimi i komunave në përputhshmërinë me kërkesat gjuhësore ka ndikuar vetëm në punën e një numri të vogël të mekanizmave, dhe se marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve kanë përfituar nga funksionimi dhe ekzistenca e të katër mekanizmave.

¹⁶⁵ Po ashtu i rekomanduar në raportin e OSBE-së 2009: "Komunikimi ndërmjet ministrive dhe institucioneve të nivelit lokal duhet të përmirësohet, gjersa zinxhiri i komandës dhe sistemi i raportimit duhet të qartësohet për të kontribuar në efikasitetin e mekanizmave". *Po aty.*, f. 27.

5. REKOMANDIME

Për t'i trajtuar dështimet e identifikuara lidhur me përputhshmërinë dhe pajtueshmërinë, rekomandimet në vijim avokojnë në favor të veprimeve specifike që duhet ndërmarrë nga institucionet lokale dhe qendrore si bartës parësorë të përgjegjësisë për sa i përket funksionimit të katër mekanizmave. Komuniteti dhe palët ndërkombëtare të interesit gjithashtu duhet të luajnë role të rëndësishme në mbështetjen e performancës së përmirësuar të mekanizmave, përkatësisht përmes pjesëmarrjes më aktive në avokim duke kontribuar në ngritje të kapaciteteve.

5.1 Për institucionet përkatëse të nivelit qendror, duke përfshirë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Administratës Publike dhe Zyrat për Çështje të Komuniteteve:

- a) Të realizojnë një proces përfshirës e konsultativ për trajtimin e zbrazëtirave të identifikuara në kuadrin ligjor që rregullon NKK-të, ZKKKK-të dhe KK-të, me fokus të veçantë në proceset e emërimit, mandatet dhe përgjegjësitë, si dhe mekanizmat për raportim dhe mbikëqyrje. Ky proces duhet të përfshijë kontributin e përfaqësuesve të qeverisë lokale dhe të komunitetave, si dhe të palëve përkatëse ndërkombëtare të interesit. Si hap i rëndësishëm në këtë proces, udhëzimi i politikave për KK-të, i përfshirë në Termat dhe Udhëzimet e tyre të Referencës, duhet të zhvillohet e fuqizohet më tej, si dhe të inkorporohet në akte nënligjore, në mënyrë që ta përmirësojë kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij.
- b) Të sigurohet qasje e plotë dhe e lehtë në ligjet dhe politikat përkatëse, përfshirë përmes publikimit të kornizës ligjore dhe të politikave në fjalë në faqet e internetit të ministrive dhe komunave në të gjitha gjuhët zyrtare, si dhe shpërndarjes së saj tek palët lokale të interesit dhe komunitetet.

5.2 Për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim:

- a) Të ushtrojnë presion në komuna për përputhshmëri të plotë me obligimet e tyre ligjore për themelimin e katër mekanizmave në lidhje me KK-të dhe ZKKKK-të, si dhe për NKK-të dhe ZKKKK-të në komunat ku komunitetet përbëjnë 10 për qind apo më shumë të popullatës komunale. Për të siguruar pajtueshmëri të plotë me Ligjin për vetëqeverisje lokale, të gjitha KK-të duhet të përfshijnë së paku një përfaqësues të secilit komunitet që banon në komunë (siç kërkohet me nenin 53 të Ligjit), dhe komunat duhet të ndajnë resurse adekuate operationale për funksionim të KK-ve, duke përfshirë për përkthim me shkrim dhe me gojë dhe për shërbime të transportit për vizita në terren.
- b) T'i inkurajojnë komunat që të themelojnë pozita të NKK-ve në raste kur shihet si e duhur por jo e detyrueshme, për shembull, në komuna ku komunitetet përbëjnë më pak se 10 për qind të popullsisë së komunës, por janë të pranishme në numër të konsiderueshëm, ose ku çështje të veçanta e meritojnë përkrahjen shtesë që do ta siguronte një pozitë e NKK-së.

- c) Të kryejnë monitorim të rregullt dhe transparent të funksionimit të katër mekanizmave. Duke ndërtuar mbi atë që është vepruar apo ndërmarrë deri më tani, monitorimi duhet të përfshijë vlerësimin e çdo detyre që parasheh mandati i mekanizmit, shqyrtim të raporteve të nxjerra nga mekanizmi në nivel lokal dhe nxitje të informatave kthjese nga komunitetet lokale përmes konsultimit kuptimplotë. T'i publikojnë të gjitha raportet nga monitorimi në ueb-faqet e ministrisë në gjuhët zyrtare dhe të sigurojnë ndërmarrjen e hapave të duhura vijuese për adresimin dhe identifikimin e problemeve, si dhe për të siguruar përputhshmëri të plotë dhe funksionim të përmirësuar, sipas nevojës.
- d) Një vit pas futjes në përdorim të legjislacionit të ri ose udhëzimeve të politikave të reja, të ndërmarrin një vlerësim të hollësishëm të zbatimit të tyre nga institucionet lokale, duke përfshirë rekomandime për përmirësimet e nevojshme për aktorë specifikë. T'i publikojnë dhe të diskutojnë hollësisht për gjetjet e vlerësimit në fjalë me komunat gjegjëse, si dhe me organet përkatëse siç janë Zyra për çështje të komuniteteve dhe Këshilli Konsultativ për Komunitete dhe të ndjekin zbatimin e atyre rekomandimeve.
- e) T'ju sigurojnë hisedarëve lokalë përkrahje dhe udhëzim adekuat për funksionimin e duhur të katër mekanizmave. Të ndërmarrin aktivitete kontaktimi për këshillimin e zyrtarëve komunalë dhe përfaqësuesit e komuniteteve për kornizën ligjore dhe të politikave, të sigurojnë trajnim për përgjegjësitë sipas nevojës (p.sh. për shqyrtim buxhetor, monitorim të projekteve, dialogun ndërmjet komuniteteve), të promovojnë praktika të mira dhe të adresojnë çfarëdo çështjesh specifike të identifikuar nga monitorimi ose të ngritura nga hisedarët lokalë. Të konsiderojnë krijimin e pikave specifike të kontaktit brenda MAPL-së, siç janë ato ekzistuese brenda MKK-së, me përgjegjësi për të siguruar përkrahje dhe udhëzim për mekanizmat dhe institucionet e nivelit lokal, si dhe për t'i ndjekur çështjet që kanë të bëjnë me përputhshmërinë ose kapacitete të dobëta.

5.3 Për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët:

- a) Të vazhdojë me monitorimin e institucioneve komunale dhe katër mekanizmat mbrojtës për përputhshmëri të plotë me detyrimet gjuhësore dhe të ndërmerr veprime për t'i adresuar të gjitha ankesat për shkelje të të drejtave gjuhësore.

5.4 Për komunat, duke përfshirë këtu udhëheqësinë komunale, zyrat komunale për komunitete dhe kthim, komitetet për komunitete, nënkryetarët e komunave për komunitete dhe zëvendëskryesuesit e kuvendeve komunale për komunitete:

- a) Të ndërmarrin veprime të menjëhershme për të siguruar që organet e detyrueshme si komiteti për komunitete dhe zyra komunale për komunitete dhe kthim të themelohen në të gjitha komunat dhe të themelohen pozitivat e nënkryetarëve për komunitete dhe zëvendëskryesuesve të kuvendeve komunale për komunitete në komuna ku komunitetet përbëjnë 10 për qind ose më shumë të popullsisë lokale, në përputhje me obligimet përkatëse ligjore. Pasi të jenë

themeluar, përbërja e secilës KK duhet të përfshijë së paku një përfaqësues nga secili komunitet që banon në komunë, siç kërkohet me nenin 53 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

- b) Të marrin në konsideratë themelimin e pozitive të NKK-ve ku shihet si e duhur, por që nuk është e detyrueshme, gjegjësisht në komuna ku komunitetet përbëjnë më pak se 10 për qind të popullatës së komunës, por megjithatë janë në numër të konsiderueshëm, ose ku çështje të veçanta meritojnë emërimin e një pozite të tillë të NKK-së për të siguruar përkrahje të nevojshme shtesë për qeverisjen komunale ose komunitetet rezidente.
- c) Të sigurojnë që mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve t'i kenë resurset praktike që u nevojiten për të funksionuar në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe hapësira të mjaftueshme pune për mbajtje të takimeve dhe/ose punë ditore, kompjuterë dhe qasje në telefon, si dhe transport për vizitat e kontaktimit dhe fonde për shërbime të përkthimit me shkrim dhe me gojë. Nëse kapacitetet e dobëta njerëzore identifikohen si problem në përmbushje të përgjegjësisë të caktuara, të shqyrtohen mundësitë për trajnime specifike (p.sh. për shqyrtim buxhetor, monitorim të projekteve, dialog ndërmjet komuniteteve), duke përfshirë përmes parashtrimit të kërkesave në institucionet relevante qendrore për përkrahje në trajnim, në veçanti MAPL dhe MKK.
- d) Të sigurojnë që mekanizmat punojnë bashkërisht me qasje koherente për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Të inkurajojnë shkëmbimin e drejtpërdrejtë të informacioneve ndërmjet KK-ve dhe ZKKK-ve si praktikë standarde dhe, aty ku ekzistojnë pozitat e NKK-së dhe ZKKKK-së, të nxisin raportimin e rregullt të ZKKK-së pranë NKK-së dhe pjesëmarrjen e ZKKKK-së në takimet e KK-së. Të gjitha mekanizmat në çdo komunë duhet të inkurajohen të mbajnë takime mujore për t'i shqyrtuar çështje aktuale dhe diskutuar e bashkërenduar përgjigjet dhe veprimet.
- e) T'i përmirësojnë proceset e emërimit dhe rekrutimit duke siguruar që përzgjedhja bëhet në përputhje të plotë me udhëzimet relevante ligjore dhe të politikave dhe bazuar në procese transparente të vendimmarrjes, në mënyrë që të sigurohet se të emëruarit kanë njohurinë dhe përvojën e nevojshme. Të ndërmarrin hapa konkretë për përmirësimin e balancës gjinore në mekanizmat për mbrojtje të komuniteteve, duke përfshirë përmes kontaktimit për inkurajimin e kandidateve femra (p.sh. përfshirjes së grupeve lokale të grave dhe grupeve të grave anëtare të kuvendeve në përpyetje për t'i identifikuar dhe kontaktuar kandidatet potenciale).
- f) Të sigurojnë raportim transparent të punës të katër mekanizmave. Në veçanti, të sigurojnë që i tërë raportimi formal i përcaktuar në hollësi në legjislacion ose udhëzime të politikave të zbatohet në tërësi, të publikohet në të gjitha gjuhët zyrtare dhe të shpërndahet tek të gjitha departamentet komunale, përfaqësuesit e komunitetit (p.sh. përmes KK-ve, medieve lokale, shoqërisë civile, etj.) dhe institucioneve qendrore relevante.

- g) Të përmirësojnë rrjedhën e informacioneve ndërmjet komuniteteve dhe katër mekanizmave. Të sigurojnë që komunitetet të kenë qasje të lehtë në katër mekanizmat: t'i publikojnë emrat e personave të emëruar dhe informacionet përkatëse për kontaktim dhe, për mekanizmat specifik, të vihet në funksion dhe publikohet një politikë pune e derës së hapur për pranimin e palëve që dëshirojnë të diskutojnë për çështje relevante, gjegjësisht anëtarëve të publikut, një herë në javë. Të sigurojnë që raportet e progresit e të katër mekanizmave t'ju shpërndahen përfaqësuesve të komunitetit (p.sh. përmes KK-ve, medieve lokale, shoqërisë civile, etj.) Sipas nevojës, të shtohen aktivitetet e kontaktimit të komunitetit për informim më të mirë për punën e mekanizmave dhe për të mbledhur informacione për nevojat dhe çështjet e komunitetit.
- h) Të ndërmarrin hapa për fuqizimin e katër mekanizmave dhe t'i inkurajojnë të gjithë aktorët komunalë që të tregojnë respekt të duhur ndaj tyre si elementë të rëndësishëm të qeverisjes lokale. Udhëheqësia komunale duhet të prijë me shembull në përkrahje të fuqizimit të tillë. Aty ku është e dobishme ose e nevojshme, komunat do të duhej të aranzhonin trajnime teknike për katër mekanizmat dhe/ose trajnime më të përgjithshme për aktorët e tjerë komunalë dhe hisedarët për mandatet, raportimin dhe aktivitetet e kontaktimit të mekanizmave
- i) Ta njohin drejtpërdrejtë potencialin e katër mekanizmave për të kontribuar në përmirësimin e raporteve ndërmjet komuniteteve, duke përfshirë përmes zhvillimit specifik të kapaciteteve për pozitat kyçe në raste të duhura.

SHTOJCA 1 – TABELA: THEMELIMI I MEKANIZMAVE LOKALË PËR MBROJTJE (NDARJA SIPAS KOMUNAVE)

Pasqyrë e përgjithshme e themelimit të katër mekanizmave, siç ishte në tetor 2013:

Komuna	NKK	ZKXXX	KK	ZKKK	Komente
Ferizaj/Uroševac			✓	✓	
Gjilan/Gnjilane	✓*	✓	✓	✓	Pozita e NKK-së dhe e ZKXXX-së janë themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet (*pozita e NKK-së e lirë që në tetor 2013).
Hani i Elezit/Elez Han			✓	✓	
Kaçanik/Kaçanik			✓	✓	
Kamenicë/Kamenica	✓	✓	✓	✓	Pozita e NKK-së dhe e ZKXXX-së janë themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet.
Klokot-/Kllokot-	✓	✓	✓	✓	
Novobërdë/Novo Brdo	✓	✓	✓	✓	
Parteš/Partesh			✓	✓	
Ranilug/Ranillug	✓	✓*	✓	✓	Pozita e NKK-së dhe e ZKXXX-së janë themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet (*pozita e ZKXXX-së e lirë që në shtator 2012).
Štrpce/Shtërpçë	✓	✓	✓	✓	
Viti/Vitina			✓	✓	
Mitrovicë/Mitrovica	✓	✓	✓	✓	Pozita e NKK-së dhe e ZKXXX-së janë themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet.
Skenderaj/Srbica			✓	✓	
Vushtrri/Vučitrn			✓	✓	
Glllogovc/Glllogovac			✓	✓	
Podujevë/Podujevo			✓	✓	
Deçan/Deçane			✓	✓	
Gjakovë/Đakovica		✓	✓	✓	Pozita e ZKXXX-së është themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet.
Istog/Istok		✓	✓	✓	Pozita e ZKXXX-së është themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet.
Junik			✓	✓	
Klinë/Klina			✓	✓	
Pejë/Peć	✓	✓	✓	✓	Pozita e NKK-së dhe e ZKXXX-së janë themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet.
Fushë Kosovë/Kosovo Polje	✓	✓	✓	✓	
Gračanica/Gračanicë	✗	✓	✓	✓	Pozita e NKK-së nuk është themeluar përkundër pragut të arritur prej 10% .
Lipjan/Lipljan	✓		✓	✓	Pozita e NKK-së është themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet (megjithatë mbahet nga përfaqësuesi i komunitetit në shumicë numerike në komunë).
Obiliq/Obilić	✓		✓	✓	Pozita e NKK-së është themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet.
Shtime/Štimlje			✓	✓	
Prishtinë/Priština		✓	✓	✓	Pozita e ZKXXX-së është themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet
Dragash/Dragaš	✓	✓	✓	✓	
Malishevë/Mališevo			✓	✗	Nuk ka ZKKK të themeluar zyrtarisht , është emëruar vetëm një zyrtar
Mamuša/Mamushë/ Mamuša	✓		✓	✓	Pozita e NKK-së është themeluar ndonëse një gjë e tillë nuk kërkohet.
Prizren	✓	✓	✓	✓	
Rahovec/Orahovac			✓	✓	
Suharekë/Suva Reka			✓	✓	
Gjithsej	14	14	34	33	2 komuna nuk i kishin krijuar mekanizmat e detyrueshme. 11 komuna, ndonëse nuk kanë qenë të detyruara, kishin themeluar të tilla pozita.

SHTOJCA 2 – TABELA: PËRKATËSIA ETNIKE DHE GJINIA E NKK-ve DHE ZKKKK-ve (NDARJA SIPAS KOMUNAVE)

Pasqyrë e përgjithshme e emërimit të NKK-ve dhe ZKKKK-ve sipas komunitetit, gjinisë dhe komunës, në tetor 2013:


Komunat	NKK-të			ZKKKK-të		
	Meshkuj	Femra	Komuniteti	Meshkuj	Femra	Komuniteti
Ferizaj/Uroševac						
Gjilan/Gnjilane	✓		Serb i Kosovës ¹⁶⁶	✓		Turk i Kosovës
Hani i Elezit/Elez Han						
Kaçanik/Kaçanik						
Kamenicë/Kamenica	✓		Serb i Kosovës	✓		Serb i Kosovës
Klokot-/Kllokot-	✓		Shqiptar i Kosovës	✓		Shqiptar i Kosovës
Novobërdë/Novo Brdo	✓		Serb i Kosovës	✓		Serb i Kosovës
Parteš/Partesh						
Ranilug/Ranillug	✓		Shqiptar i Kosovës	I lirë		n/z
Štrpce/Shtërpçë	✓		Shqiptar i Kosovës	✓		Shqiptar i Kosovës
Viti/Vitina						
Mitrovicë/Mitrovica	✓		Turk i Kosovës		✓	Turk i Kosovës
Skenderaj/Srbica						
Vushtrri/Vučitrn						
Gllgovc/Glogovac						
Podujevë/Podujevo						
Deçan/Deçane						
Gjakovë/Đakovica				✓		Egjiptian i Kosovës
Istog/Istok				✓		Egjiptian i Kosovës
Junik						
Klinë/Klina						
Pejë/Peç	✓		Boshnjak i Kosovës	✓		Boshnjak i Kosovës
Fushë Kosovë/Kosovo Polje	✓		Malazet i Kosovës	✓		Egjiptian i Kosovës
Gračanica/Gračanicë				✓		Shqiptar i Kosovës
Lipjan/Lipljan	✓		Shqiptar i Kosovës			
Obiliq/Obilić	✓		Serb i Kosovës			
Shtime/Štimlje						
Prishtinë/Priština				✓		Turk i Kosovës
Dragash/Dragaš	✓		Boshnjak i Kosovës	✓		Boshnjak i Kosovës
Malishevë/Mališevo						
Mamuša/Mamushë/Mamuša		✓	Shqiptar i Kosovës			
Prizren	✓		Turk i Kosovës	✓		Boshnjak i Kosovës
Rahovec/Orahovac						
Suharekë/Suva Reka						
Totali	13	1	14 pozita	13 (14)	1	14 pozita + një e lire

¹⁶⁶ Vendi i punës i lirë që nga tetori 2013.

SHTOJCA 3 – DIAGRAMI: PËRFAQËSIMI I MANGËT (JO I KËNAQSHËM) I KOMUNITETEVE NË KK (NDARJA SIPAS KOMUNITETIT)

Ashtu siç u përmend në Pjesën 3.3, kur është bërë vlerësimi i anëtarësisë së KK-ve kundrejt regjistrimit të vitit 2011, është gjetur se të gjitha KK-ve u mungonin përfaqësues nga komunitete të regjistruara si banorë të komunës në regjistrimin e popullsisë. Pa marrë parasysh se sa është numri i anëtarëve të një komuniteti që banon në një komunë të caktuar, ligji kërkon që të ketë anëtar në KK.

Diagrami i mëposhtëm i paraqet proporcionet e përgjithshme të komuniteteve të ndryshme të pa përfaqësuar në KK si kërkohet, më saktë, komunitetet që banojnë në një komunë sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, por të cilët nuk kanë përfaqësues në KK-të e tyre, siç ishte në tetor 2013.



SHTOJCA 4 – TABELA: NUMRI DHE GJINIA E ANËTARËVE TË KK DHE PUNONJËSVE TË ZKKK (SIPAS KOMUNAVE)


Pasqyrë e përgjithshme e anëtarëve të KK-ve dhe punonjësve të ZKKK-ve sipas komunave që paraqet përfaqësimin sipas gjinisë dhe përqindjen e femrave nga tetori 2013:

Komuna	Anëtarë të KK-ve				Punonjës të ZKKK-ve			
	Meshkuj	Femra	Gjiths ej	% femr a	Meshkuj	Femra	Gjiths ej	% femr a
Ferizaj/Uroševac	5	2	7	29	10	3	13	23
Gjilan/Gnjilane	7	0	7	0	6	0	6	0
Hani i Elezit/Elez Han	3	2	5	40	1	0	1	0
Kaçanik/Kaçanik	4	1	5	20	3	0	3	0
Kamenicë/Kamenica	6	4	10	40	4	3	7	43
Klokot-/ Klokot-	5	0	5	0	1	1	2	50
Novo Brdo/Novobërdë	4	3	7	43	2	1	3	33
Parteš/Partesh	3	2	5	40	2	0	2	0
Ranilug/Ranillug	3	4	7	57	1	1	2	50
Štrpce/Shtërpçë	4	4	8	50	1	1	2	50
Viti/Vitina	5	0	5	0	3	0	3	0
Mitrovicë/Mitrovica	6	1	7	14	3	3	6	50
Skenderaj/Srbica	6	1	7	14	3	2	5	40
Vushtrri/Vuçitrn	6	3	9	33	4	1	5	20
Glllogovc/Glllogovac	3	4	7	57	0	1	1	100
Podujevë/Podujevo	6	1	7	14	2	0	2	0
Deçan/Deçane	1	4	5	80	3	1	4	25
Gjakovë/Đakovica	4	3	7	43	4	1	5	20
Istog/Istok	5	0	5	0	6	2	8	25
Junik	5	0	5	0	1	0	1	0
Klinë/Klina	5	2	7	29	4	1	5	20
Pejë/Peć	6	1	7	14	6	3	9	33
Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	8	1	9	11	4	1	5	20
Gračanica/Gračanicë	5	0	5	0	2	0	2	0
Lipjan/Lipljan	7	2	9	22	5	2	7	29
Obiliq/Obilić	6	3	9	33	4	5	9	56
Shtime/Štimlje	3	2	5	40	2	1	3	33
Prishtinë/Priština	6	3	9	33	2	2	4	50
Dragash/Dragaš	2	3	5	60	5	0	5	0
Malishevë/Mališevo	3	2	5	40	0	1	1	100
Mamuša/Mamushë/Mamuša	6	1	7	14	2	0	2	0
Prizren	4	3	7	43	4	2	6	33
Rahovec/Orahovac	7	2	9	22	2	5	7	71
Suharekë/Suva Reka	4	3	7	43	1	0	1	0
Gjithsej	163	67	230	29 gjithsej % femra	103	44	147	30 gjithsej % femra

SHTOJCA 5 – DIAGRAME: PËRGJIGJET NË ANKETË NGA MEKANIZMAT PËR KOMUNIKIM, BASHKËPUNIM DHE PËRDORIM TË GJUHËVE

Diagramet që paraqesin vlerësimet dhe përgjigjet nga të anketuarit në pyetjet që u janë bërë për përvojat e tyre gjatë periudhës kohore prill 2012 – prill 2013. Siç shihet në diagrame, në mesin e të anketuarve kishte NKK, ZKXXX, anëtarë të KK-ve dhe punonjës të ZKXX-ve.


i.



ii.

A pranoi informacione për takimet komunale ose mbledhjet e kuvendit komunal dhe a pranoi dokumente relevante për shqyrtim rregullisht dhe pa probleme?


■ NKK ■ ZK KKK ■ KK ■ ZKK



iii.

Si do ta vlerësonit bashkëpunim tuaj me tre mekanizmat e tjerë të pjesëmarrjes së komunitetit? (më saktë, sa rregullisht dhe me sukses shkëmbejeni informacione, mbani takime të përbashkëta, bashkërendoni veprime, mbështetje të ndërsjellë për avokim/lobim për


■ NKK ■ ZK KKK ■ KK ■ ZKK




iv.

A jeni përballur me ndonjë problem në përdorimin e gjuhëve në përdorim zyrtar dhe në qasjen në informata në gjuhët zyrtare

■ NKK ■ ZK KKK ■ KK ■ ZKK





Vlerësim i mekanizmave të nivelit lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë

Qershor, 2014

Salla e kuvendit komunal, komuna Klinë/Klina, 26 Maj 2014, OSCE/Driton Marku.